



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 120, datë 15.03.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR PERIUdhËN  
2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatores znj. Irena Plaku,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A NJOHURITË LIGJORE.

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:**

**Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes**, gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes, natyrës së çështjes (*civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale e fazës së hetimit*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (*gjykim i shkurtuar ose gjykim me marrëveshje*), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale të cilat paraqiten në mënyrë të detajuara dhe analitike, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, por këto të fundit paraqiten në mënyrë më konçize, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar “Procedura”, në të cilën gjyqtarja parashtron vlerësimin në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Gjithashtu, edhe në vendimet penale burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi përveç vlerësimit lidhur me elementët proceduralë që lidhen me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues (elementë të cilët analizohen në çdo vendim), edhe paraqitjes dhe vlerësimit lidhur me kërkesat procedurale të palëve, sikurse

është rasti i kërkesave për procedim me gjykim të shkurtuar.<sup>1</sup> Në vendimet penale të seancës paraprake gjyqtarja përshkruan ecurinë procedurale të çështjeve sa i përket njoftimit të palëve, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre, për të vijuar me pas, si pjesë e arsytimit të vendimit, me paraqitjen dhe analizën e elementëve procedurale që lidhen me zgjidhjen e çështjes në themel, kryesisht në drejtim të (i) vlerësimit e kushteve ligjore procedurale për pranimin e kërkesës për dërgimin e çështje në gjyq; (ii) kushtet ligjore procedurale të pushimit të procedimit penal, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e faktit dhe provat”, duke i parashtruar ato në mënyrë të plotë, të qartë dhe duke integruar herë pas herë me përmbajtjen e provave dhe analizën e tyre, së bashku me faktin, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo të natyrës së gjykimit, sipas kërkesës objekt shqyrtimi. Në çështjet penale konstatohet se gjyqtarja pas parashtrimit të fakteve të çështjes në mënyrë të përmbledhur liston provat mbi bazën e të cilës provohet këto fakte, të cilat jo gjithmonë integrohen me përmbajtjen dhe analizën e provave.

**Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes**, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit, në çështjet civile, ndërsa në çështjet penale, natyra e çështjes përcaktohet që në pjesën e parë të arsytimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprake, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsytimit, duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsytimit. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtares, duke u bërë përgjithësisht në mënyrë të shprehur ose duke zhvilluar analizën ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, sikurse është rasti i çështjeve civile, në të cilat ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale,<sup>2</sup> në lidhje me kompetencën për shqyrtimin e çështjes.

**Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm**, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

*Sa i përket ligjit procedural:*

Në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenin 6, lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes civile, detyrimin e gjykatës për t’u shprehur për gjithçka që kërkohet;<sup>3</sup>
- nenet 31 dhe 32 të K.Pr.Civile në lidhje me të drejtën e padisë;<sup>4</sup>

<sup>1</sup>Vendimet nr. {...}, datë 13.05.2019, nr. {...}, datë 17.06.2019, nr. {...}, datë 02.07.2018, nr. {...}, datë 21.10.2019 dhe nr. {...}, datë 22.12.2017 të {...}.

<sup>2</sup>Vendimet nr. 421, datë 13.03.2017, nr. {...}, datë 31.03.2017, nr. {...}, datë 16.01.2017 dhe nr. {...}, datë 21.03.2017 të {...}.

<sup>3</sup>Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}

- nenet 36, 349, 41, 45, 51, 54 dhe 511 të K.Pr.Civile, nenin 7 të Kodit të Punës lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt lirim dhe dorëzim sendi, marrëdhënie pune, zgjidhje martese, lëshim urdhër ekzekutimi, etj.*).<sup>5</sup> Në një rast gjyqtarja ka referuar edhe në ligje të posaçme që përcaktojnë çështje të kompetencës lëndore dhe tokësore, duke referuar përkatësisht nenin 7/b të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe nenet 8 dhe 20/c të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;<sup>6</sup>
- nenet 35, 71, 72 dhe 73 të K.Pr.Civile lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe paanshmërinë e gjykatës;<sup>7</sup>
- nenin 176 të K.Pr.Civile në lidhje me legjitimitetin formal të palëve në gjykim;<sup>8</sup>

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit paraprak, çështje penale seancës paraprake ose themelit*), apo rritit të gjykimit (*gjykim i shkurtuar ose gjykimi me marrëveshje*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 13/3, 69/1, 74, 76 të K.Pr.Penale në drejtim të vlerësimit të përbërjes së trupit gjykues, çështjeve të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, në gjykimet penale të themelit;<sup>9</sup>
- nenet 403 dhe 405 të K.Pr.Penale, lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm të gjykimit, si dhe nenet 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale, lidhur me shpenzimet procedurale të fazës së hetimit dhe shpenzimeve gjyqësore në procesin penal;
- nenet 290, 291 dhe 329 të K.Pr.Penale, lidhur vendimi e prokurorit për mosfillimin e procedimit dhe kontrollin gjyqësor ndaj vendimeve të prokuroit në lidhje me mosfillimin e procedimit apo për pushimin e çështjes gjatë fazës së hetimeve paraprake;<sup>10</sup>
- nenin 390 lidhur me vendimin e dënimit në rastet kur i pandehuri deklarohet fajtor, nenin 388 të K.Pr.Penale në rastin e deklarimit të pafajshëm të autorit;<sup>11</sup>
- nenet 38 dhe 39 të K.Pr.Penale në lidhje me pyetjen e të pandehurit, nenin 128 të K.Pr.Penale në lidhje me pavlefshmërinë absolute të akteve procedurale, nenin 332/c pika 3 të K.Pr.Penale mbi mënyrën dhe zhvillimin e seancës paraprake dhe të drejtën që ka i pandehuri për të kërkuar gjykimin e shkurtuar vetëm në seancë paraprake, nenet 332/dh, 332/ë të K.Pr.Penale, lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e gjykatës në seancë paraprake, disponimin me vendim për dërgimin e çështjes në gjyq, formimin e fashikullit të gjykimit dhe depozitimin e dosjes për t’iu nënshtruar procedurave të shortit;<sup>12</sup>
- Në çështjet e seancës paraprake me objekt “*Pushimin e procedimit penal*”, krahas dispozitave procedurale lidhur me vlerësimin e çështjeve të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues (*nenet 69 dhe 13/2,c të K.Pr.Penale*), gjyqtarja identifikon nenet 329/a, 328/1 të K.Pr.Penale, lidhur me aspektet procedurale të shqyrtimit të kërkesës për pushimin e procedimit penal dhe rastet e pushimit të

<sup>4</sup>Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017, i {...}.

<sup>5</sup>Vendimet nr. {...}, datë 31.03.2017, nr. {...}, datë 13.03.2017, nr. {...}, datë 10.04.2017 dhe nr. {...}, datë 16.01.2017 të {...}

<sup>6</sup>Vendimi nr. {...}, datë 21.03.2017 i {...}.

<sup>7</sup>Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>8</sup>Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>9</sup>Vendimet nr. {...}, datë 13.05.2019, nr. {...}, datë 17.06.2019, nr. {...}, datë 02.07.2018, nr. {...}, datë 22.12.2017, nr. {...}, datë 21.10.2019 dhe nr. {...}, datë 30.10.2019 të {...}

<sup>10</sup>Vendimi nr. {...}, datë 18.07.2018 i {...}

<sup>11</sup>Vendimi nr. {...}, datë 17.06.2019 i {...}

<sup>12</sup>Vendimet nr. {...}, datë 21.01.2019, nr. {...}, datë 26.09.2018, nr. {...}, datë 17.09.2018, nr. {...}, datë 16.04.2019 dhe nr. {...}, datë 10.07.2018 të {...}.

procedimit, si nenin 329/3/c të K.Pr.Penale lidhur me vlerësimin e gjykatës në drejtim të nevojës për kthimin e akteve duke urdhëruar që të formulohet akuzë dhe të paraqes kërkesën për gjykimin e çështjes;<sup>13</sup>

- nenet 406/d, 406/dh, 406/e, 406/ë dhe 406/f të K.Pr.Penale, lidhur me institutin e “gjykimit me marrëveshje” si një institut i ri i krijuar me ndryshimet e bëra me ligjin 35/2017, në kuadër të gjykimeve të posaçme.<sup>14</sup>

***Sa i përket ligjit material të zbatueshëm***, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori:(i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se:

*Në vendimet civile (çështje me objekt lirim dhe dorëzim sendi, marrëdhënie pune, zgjidhje martesë, lëshim urdhër ekzekutimi, etj.)*, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, që kanë lidhje kryesisht me:

- *Të drejtën e pronësisë dhe mbrojtjen e saj*, përkatësisht nenin 296 të K. Civil në lidhje me padinë e rivendikimit, nenet 302 dhe 304 të K. Civil në lidhje me tagrat kryesore të pronarit.<sup>15</sup>
- *Kontratat*, përkatësisht nenin 681 të K. Civil në lidhje me rregullat e interpretimit të kontratës.<sup>16</sup>
- *Marrëdhënien juridike të punës*, përkatësisht nenet 3-6 të K. Punës në lidhje me zbatueshmërinë e K. Punës, nenin 12 të K. Punës në lidhje me kontratën e punës, nenin 141 të K. Punës në lidhje me përfundimin e kontratës së punës kur zgjidhet nga njëra palë, nenin 144 të K. Punës në lidhje me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, nenin 145 të K. Punës në lidhje me shpërblimin për vjetërsinë në punë, si dhe nenin 153 të K. Punës në lidhje me zgjidhjen e kontratës në mënyrë të menjëhershme të pajustificuar.<sup>17</sup>
- *Titujt ekzekutivë*, përkatësisht nenin 510/a të K. Pr. Civile në lidhje me vendimet e gjykatës si titull ekzekutiv.<sup>18</sup>
- *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*, përkatësisht nenet 1, 2, 3, 50, 123, 125, 129, 132, 143, 145-155, 157, 159, 161, 215, 220, 226, të Kodit të Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj në lidhje me bashkëshortët dhe fëmijët e mitur.<sup>19</sup>

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Familjes dhe Kodit të Punës, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ dhe nenin 41 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e pronësisë<sup>20</sup>

<sup>13</sup>Vendimi nr. {...}, datë 03.07.2019 i {...}.

<sup>14</sup>Vendimi nr. {...}, datë 29.01.2019 i {...}.

<sup>15</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.

<sup>16</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.

<sup>17</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>18</sup> Vendimi nr. {...}, datë 10.04.2017 i {...}

<sup>19</sup> Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>20</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.

- nenin 44 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e zhdëmtimit të dëmit shkaktuar nga paligjshmëria e veprimtarisë së organeve shtetërore<sup>21</sup>
- nenin 49 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën e punës<sup>22</sup>
- nenet 15 dhe 53 të Kushtetutës, si dhe Konventën e OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”, në çështjen me objekt zgjidhje martesë, në lidhje me të drejtën familjare, si dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës<sup>23</sup>

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal, si më poshtë:

- Identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal: nenin 248 të K. Penal, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”<sup>24</sup>, nenin 84, 150 dhe 278/1 të K. Penal në lidhje me veprat penale “Kanosja”, “Shkatërrimi i pronës” dhe “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municionit luftarak”<sup>25</sup>, nenin 290 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”<sup>26</sup>, nenin 108/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Vepra të turpshme”<sup>27</sup>, nenin 124/b të K. Penal në lidhje me veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit”<sup>28</sup>, nenin 130/a/4 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje”<sup>29</sup>, nenin 134/1 dhe 134/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhja”<sup>30</sup>, nenin 199/a të K. Penal në lidhje me veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”<sup>31</sup>, nenin 135 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën”<sup>32</sup>, nenin 291 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”<sup>33</sup>, nenin 84 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Kanosja me motive racizimi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”<sup>34</sup>, nenin 143/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Mashtrimi”<sup>35</sup>, nenin 278/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”<sup>36</sup>, nenin 90 dhe nenin 130/a të K. Penal përkatësisht në lidhje me veprat penale “Dëmtime të tjera me dashje” dhe “Dhuna në familje”<sup>37</sup> nenin 305/b të K. Penal në lidhje me veprën penale “Deklarim i rremë para Oficerit të Policisë Gjyqësore”<sup>38</sup>.
- Dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. nenin 1/b të K. Penal në lidhje me detyrat e legjislacionit penal<sup>39</sup>, nenin 1/c të K. Penal në lidhje me parimet e K. Penal, nenin 4 të K. Penal në lidhje me parimin për mosnjohjen e ligjit penal<sup>40</sup>, nenin 12 të K.

<sup>21</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>22</sup> Vendimi nr. {...} datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>23</sup> Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>24</sup> Vendimet nr. {...}, datë 10.07.2018, nr. {...}, datë 29.10.2018, nr. {...}, datë 03.10.2018 dhe nr. {...}, datë 06.05.2019 të {...}.

<sup>25</sup> Vendimi nr. {...}, datë 03.07.2019 i {...}.

<sup>26</sup> Vendimi nr. {...}, datë 30.10.2019 i {...}.

<sup>27</sup> Vendimi nr. {...}, datë 21.01.2019 i {...}.

<sup>28</sup> Vendimi nr. {...}, datë 16.04.2019 i {...}.

<sup>29</sup> Vendimi nr. {...}, datë 17.09.2018 i {...}.

<sup>30</sup> Vendimet nr. {...}, datë 26.09.2018 dhe nr. {...}, datë 02.07.2018 i {...}.

<sup>31</sup> Vendimi nr. {...}, datë 07.11.2017 i {...}.

<sup>32</sup> Vendimi nr. {...}, datë 06.05.2019 i {...}.

<sup>33</sup> Vendimi nr. {...}, datë 22.12.2017 i {...}.

<sup>34</sup> Vendimi nr. {...}, datë 29.01.2019 i {...}.

<sup>35</sup> Vendimi nr. {...}, datë 18.07.2018 i {...}.

<sup>36</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.05.2019 i {...}.

<sup>37</sup> Vendimi nr. {...}245, datë 17.06.2019 i {...}.

<sup>38</sup> Vendimi nr. {...}, datë 21.10.2019 i {...}.

<sup>39</sup> Vendimi nr. {...}, datë 02.07.2018 i {...}.

<sup>40</sup> Vendimi nr. {...}, datë 22.12.2017 dhe nr. 331, datë 02.07.2018 të {...}

Penal në lidhje me moshën për përgjegjësi penale<sup>41</sup>, nenin 16 të K. Penal në lidhje me pakujdesinë<sup>42</sup>, nenin 18 të K. Penal në lidhje me kryerjen e veprës penale në gjendje të dehur<sup>43</sup>, nenin 19 të K. Penal në lidhje me mbrojtjen e nevojshme<sup>44</sup>, nenin 47 të K. Penal në lidhje me kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit,<sup>45</sup> nenet 48-50 në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese<sup>46</sup>, nenin 51 të K. Penal në lidhje me dënimin me burgim për të miturit<sup>47</sup>, nenet 59 dhe 63 të K. Penal në lidhje me dënimet alternative<sup>48</sup>, nenin 66 të K. Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale, nenin 68 të K. Penal në lidhje me mosparashkrimin e ndjekjes penale, nenin 69 të K. Penal në lidhje me parashkrimin e ekzekutimit të vendimit<sup>49</sup>, etj.

Gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të ligjeve të posaçme dhe akte nënligjore, në funksion të argumentimit lidhur me anën objektive të veprave penale, konkretisht:

- nenet 39 dhe 41 të ligjit nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”* në lidhje me lejen e ndërtimit dhe deklaratën paraprake për kryerjen e punimeve, si dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”*<sup>50</sup>;
- nenin 3 pika 6 dhe 7/b të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* në lidhje me termat njësi shtëpiake dhe pjestare të familjes<sup>51</sup>;
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”* i ndryshuar<sup>52</sup>;
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”* i ndryshuar (vendimi nr. 1720, datë 29.10.2018) VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* të ndryshuar<sup>53</sup>.

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 148 të Kushtetutës, lidhur me përcaktimin e funksionit kushtetutës të organit të Prokurorisë<sup>54</sup>;
- nenet 42/2 të Kushtetutës, lidhur me me të drejtën e një gjykimi të drejtë<sup>55</sup>;

---

<sup>41</sup> Vendimi nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, datë 29.01.2019, nr. {...}, datë 22.12.2017, nr. {...}, datë 02.07.2018, nr. {...}, datë 13.05.2019, nr. {...}, datë 17.06.2019 dhe nr. {...}, datë 21.10.2019 të {...}.

<sup>42</sup> Vendimi nr. {...}, datë 22.12.2017 i {...}.

<sup>43</sup> Vendimi nr. {...}, datë 02.07.2018 i {...}.

<sup>44</sup> Vendimi nr. {...}, datë 17.06.2019 i {...}.

<sup>45</sup> Vendimin nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, 746, datë 22.12.2017, nr. {...}, datë 02.07.2018, nr. {...}, datë 13.05.2019 dhe nr. {...}, datë 17.06.2019 të {...}.

<sup>46</sup> Vendimet nr. {...}, datë 30.10.2019 dhe nr. {...}, datë 13.05.2019 të {...}.

<sup>47</sup> Vendimi nr. {...}, datë 22.12.2017 i {...}.

<sup>48</sup> Vendimin nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, datë 22.12.2017 dhe nr. {...}, datë 02.07.2018 të {...}.

<sup>49</sup> Vendimet nr. {...}, datë 20.07.2018, nr. {...}, datë 21.09.2018 dhe nr. {...}240, datë 31.01.2018 të {...}.

<sup>50</sup> Vendimi nr. {...}, datë 07.11.2017 i {...}.

<sup>51</sup> Vendimi nr. {...}, datë 17.06.2019 i {...}.

<sup>52</sup> Vendimi nr. {...}, datë 29.10.2018 i {...}.

<sup>53</sup> Vendimi nr. {...}, datë 03.10.2018 i {...}.

<sup>54</sup> Vendimet nr. {...}, datë 10.07.2018, nr. {...}, datë 29.10.2018, nr. {...}, datë 03.07.2019 nr. {...}, datë 17.09.2018, nr. {...}, datë 16.04.2019, nr. {...}, datë 21.01.2019, nr. {...}, datë 26.09.2018, nr. {...}, datë 03.10.2018, nr. {...}, datë 07.11.2017, nr. {...}, datë 06.05.2019, nr. {...}, datë 22.01.2019 dhe nr. {...}, datë 18.07.2018 të {...}.

- nenin 53 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për familje<sup>56</sup> ;
- nenin 30 të Kushtetutës në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë<sup>57</sup>.

***Sa i përket konfliktit të normave***, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsytimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

***Në tërësi***, spikat aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen në trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

#### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtarës është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimin e tyre në mënyrë abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur. Konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përjasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

<sup>55</sup> Vendimet nr. {...}, datë 29.10.2018 , nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, datë 20.07.2018, nr. {...}, datë 03.10.2018, nr. {...}, datë 07.11.2017, nr. {...}, datë 21.09.2018, nr. {...}, datë 31.01.2018, nr. {...}, datë 06.05.2019 dhe nr. {...}, datë 22.12.2017 të {...}.

<sup>56</sup> Vendimi nr. {...}, datë 17.06.2019 i {...}.

<sup>57</sup> Vendimi nr. {...} datë 22.12.2017 i {...}.



- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm***

***Në vendimet civile*** përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

- Merr në analizë të drejtën e pronës, duke u ndalur në konceptin dhe karakteristika e saj, si dhe tagrat që burojnë prej saj. Gjithashtu, merr në analizë padinë e rivendikimit si një ndër paditë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, referuar nenit 296 të K. Civil. Në këtë kuadër, ndalet në analizën dhe interpretimin e tre kushteve të saj dhe konkretisht: (i) së pari, pala që ngre këtë padi, duhet të jetë pronar ose bashkëpronar i sendit që kërkon të kthehet (ii) së dyti, kjo padi duhet t'i kundrejtohet çdo poseduesi ose mbajtësi, i cili duhet të jetë i njohur nga ana e palës që kërkon kthimin e sendit; (iii) së treti, objekti i padisë së rivendikimit është sendi i luajtshëm ose i paluajtshëm (individualisht i përcaktuar).<sup>58</sup>
- Interpreton nenin 153 të K. Punës, në lidhje me zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës. Në këtë kuadër, sqaron kushtet që duhet të respektohen në mënyrë që punëdhënësi të mund të zgjidhë kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme, duke renditur si të tilla: (i) Punëmarrësi duhet të ketë shkelur një detyrim kontraktual (nenet 22-26 të K. Punës); (ii) Kjo shkelje duhet të jetë kryer me faj të rëndë ose me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërim me shkrim nga punëdhënësi; (iii) Midis shkeljes së detyrimit me faj nga punëmarrësi dhe pushimit të menjëhershëm nga puna ekziston lidhja shkakësore; (iv) Shkelja e detyrimit me faj duhet të ketë krijuar një situatë të rëndë që nuk lejon, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet punëdhënësit vazhdimi i marrëdhënies të punës.<sup>59</sup>
- Trajton konceptin e titullit ekzekutiv, duke u ndalur në kuptimin dhe kategoritë e tij.<sup>60</sup>
- Trajton martesën si institut juridik, duke evidentuar parimet bazë mbi të cilat mbështetet ajo, rastet e zgjidhjes së saj dhe shkaqet ligjore, si dhe pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke analizuar gjerësisht dispozitat përkatëse të K. Familjes, si dhe ato të Kushtetutës dhe të akteve ndërkombëtare në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.<sup>61</sup>

***Në vendimet penale*** gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (nenet 290/2, 291, 134, 278/1, 130/a/1, 305/b të Kodit Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K. Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.<sup>62</sup>

<sup>58</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.

<sup>59</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>60</sup> Vendimin nr. {...}, datë 10.04.2017 i {...}.

<sup>61</sup> Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>62</sup> Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes.

Përgjithësisht, dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen duke zbërthyer të katër elementët e figurës së veprës penale, objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të saj. Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K.Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë *blankete*, gjyqtarja zbaton edhe ligjet e veçanta ku të referon fakti penal.<sup>63</sup>

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtarja interpreton dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në drejtim të elementëve dhe instituteve, si më poshtë:

- Në lidhje me dënimin penal, qëllimin, parimet, si dhe kushtet dhe kriteret ligjore që merren në konsideratë në caktimin dhe individualizimin e tij<sup>64</sup>.
- Në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit, interpreton dispozitën përkatëse (59 dhe 63 të K. Penal ), duke u ndalur kryesisht në kushtet e aplikimit<sup>65</sup>.

***Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale*** civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet e seancave paraprake, në çështjen në të cilën është vendosur deklarimi i moskompetencës lëndore etj. Konkretisht:

- Në vendimet e kategorisë së çështjeve seancë paraprake (*dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal*), gjyqtarja i kushton rëndësi interpretimit të normave procedurale penale në drejtim të konceptit të ndjekjes penale dhe rolit të prokurorisë në kuadër të saj, përcaktimit të rolit të gjykatës në kontrollin dhe vlerësimin e veprimeve të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak, analizës së aspektit procedural të këtij instituti të ri procedural (*seancës paraprake*), funksionin e kësaj faze procedurale, si dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake në funksion të vlerësimit të plotësimin të kushteve dhe kriterëve ligjore për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal.<sup>66</sup>
- Në vendimin me objekt miratimin e marrëveshjes së fajësisë, gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së institutit të “*Gjykimit me marrëveshje*”, duke u fokusuar në analizën e kushteve të tij, pozitive dhe penguese<sup>67</sup>.
- Në vendimin me objekt ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal gjyqtarja ndalet në konceptin e ndjekjes penale dhe rolin e prokurorisë në kuadër të saj, si dhe rolin e gjykatës në kontrollin e veprimtarisë hetimore të prokurorisë<sup>68</sup>.

---

<sup>63</sup>Konkretisht, në vendimin nr. {...}, datë 17.06.2019, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 të K. Penal, në analizë të objektit të veprës penale, gjyqtarja referon në dispozitat e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*” i ndryshuar. Ndërsa, në vendimin 746, datë 22.12.2017, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në analizë të objektit dhe anës objektive të veprës penale, gjyqtarja referon në dispozitat e Kodit Rrugor.

<sup>64</sup>Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza e dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me kriteret e caktimit dhe individualizimit të dënimit.

<sup>65</sup>Vendimet nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, datë 22.12.2017, nr. {...}, datë 02.07.2018 dhe nr. {...}, datë 13.05.2019 të {...}.

<sup>66</sup>Vendimet nr. {...}, datë 10.07.2018, nr. {...}, datë 29.10.2018, nr. {...}, datë 03.07.2019, nr. {...}, datë 17.09.2018, nr. {...}, datë 16.04.2019, nr. {...}, datë 21.01.2019, nr. {...}, datë 26.09.2018, nr. {...}, datë 20.07.2018, nr. {...}, datë 03.10.2018, nr. {...}, datë 07.11.2017, nr. {...}, datë 21.09.2018, nr. {...}, datë 31.01.2018, {...}, datë 06.05.2019 dhe nr. {...}, datë 22.01.2019 të {...}.

<sup>67</sup> Vendimi nr. {...}, datë 29.01.2019 i {...}.

<sup>68</sup> Vendimin nr. {...}, datë 18.07.2018 i {...}.

- Në çështjet penale të themelit, gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar<sup>69</sup>, duke referuar edhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë (*vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*) dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese (*vendimi nr. 4, datë 10.02.2012 dhe nr. 24, datë 30.04.2012*)<sup>70</sup>
- Në vendimin për të cilin është disponuar për deklarimin e moskompetencës lëndore, gjyqtarja zhvillon analizën e kompetencës lëndore në kuptimin e përgjithshëm, duke u ndalur në kuptimin dhe rëndësinë e saj. Gjithashtu, evidenton dhe zbërthen dy kriteret që shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore: a) gjendja faktike ekzistuese (natyra juridike e mosmarrëveshjes); b) Ligji i aplikueshëm.<sup>71</sup>
- Në çështjen familjare (*zgjidhje martese*) gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në drejtim të vlerësimit lidhur me kompetencën tokësore për shqyrtimin e çështjes, si dhe përcaktimin e qëllimit të zhvillimit të seancës së pajtimit.<sup>72</sup>
- Në çështjet civile të themelit, gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në drejtim të vlerësimit lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjes<sup>73</sup>, të kërkesës për shtimin e objektit të padisë<sup>74</sup>, të zbatueshmërisë së Kodit të Punës në kohë, hapësirë dhe ndaj personave<sup>75</sup>.

***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante***, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Në vendimin civil me objekt *shpërblimin e dëmit nga zgjidhja e marrëdhënies së punës*, gjyqtarja ka referuar vendimin nr. 1, datë 10.01.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me nenin 7 të K. Punës<sup>76</sup>;
- Në vendimin civil me të cilin ka disponuar për deklarimin e moskompetencës lëndore, gjyqtarja ka referuar vendimin nr. 19, datë 25.04.2013, nr. 16, datë 27.03.2012, nr. 23, datë 23.07.2009 dhe nr. 9, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me parimin “*gjykatë e caktuar me ligj*”, vendimin unifikues nr. 3, datë 06.12.2013, si dhe vendimin nr. 314, datë 14.06.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me përcaktimin e kompetencës lëndore<sup>77</sup>;
- Në vendimet penale të themelit në të cilat është paraqitur kërkesa për procedim me gjykim të shkurtuar, gjyqtarja ka referuar vendimet nr. 4, datë 10.02.2012 dhe nr. 4, datë 30.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003 në lidhje me gjykimin e shkurtuar<sup>78</sup>;
- Gjithashtu, gjyqtarja ka referuar edhe vendimin unifikues nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me gjyqtarin e hetimeve paraprake<sup>79</sup>, vendimin nr. 4, datë 07.02.2000 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me

<sup>69</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017, vendimi nr. {...}, datë 25.07.2018, vendimi nr. {...}, datë 24.10.2019 dhe vendimi nr. {...}, datë 18.04.2017.

<sup>70</sup> Vendimet nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, datë 02.07.2018, nr. {...}, datë 13.05.2019, nr. {...}, datë 17.06.2019 dhe nr. {...}, datë 21.10.2019 të {...}.

<sup>71</sup> Vendimi nr. {...}, datë 21.03.2017 i {...}.

<sup>72</sup> Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>73</sup> Vendimet nr. {...}, datë 31.03.2017 dhe nr. {...}, datë 13.03.2017 të {...}.

<sup>74</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.

<sup>75</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>76</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>77</sup> Vendimi nr. {...}, datë 21.03.2017 i {...}.

<sup>78</sup> Vendimet nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, datë 02.07.2018, nr. {...}, datë 13.05.2019, nr. {...}, datë 17.06.2019 dhe nr. {...}, datë 21.10.2019 të {...}.

<sup>79</sup> Vendimi nr. {...}, datë 18.07.2018 i {...}.

parimin e prezumimit të pafajësisë<sup>80</sup>, si dhe vendimin nr. 222, datë 12.09.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me fillimin e procedimit penal<sup>81</sup>

***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i përhershëm i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimet bazë të procesit gjyqësor civil si parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve<sup>82</sup>, parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, si dhe parimin e proporcionalitetit<sup>83</sup>;
- Parimin e interesit më të lartë të të miturit, duke cituar nenin 2 të K. Familjes dhe nenin 3 të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve”<sup>84</sup>;
- Parimin e taksativitetit<sup>85</sup>;
- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit<sup>86</sup>;
- Parimin e ligjshmërisë – *nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i referuar dhe po ashtu i nxjerrë nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur<sup>87</sup>;
- Parimin e prezumimit të pafajësisë referuar nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 4 të K.Pr.Penale<sup>88</sup>;
- Parimin e procesit të rregullt ligjor, i cili jo vetëm referohet drejtpërdrejt në vendime në lidhje me aspekte të procedimit, por rezultojnë edhe nga arsyetimi, duke iu referuar aspekteve procedurale të gjykimit që lidhen me njoftimin dhe pjesëmarrjen e subjekteve në proces, të drejtën e mbrojtjes, etj.<sup>89</sup>

***Në tërësi***, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

---

<sup>80</sup> Vendimi nr. {...}, datë 22.12.2017 i {...}.

<sup>81</sup> Vendimi nr. {...}, datë 18.07.2018 i {...}.

<sup>82</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.

<sup>83</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>84</sup> Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>85</sup> Vendimet nr. {...}, datë 10.07.2018, nr. {...}, datë 17.09.2018, nr. {...}, datë 16.04.2019 dhe nr. {...}, datë 26.09.2018 nr. {...}, datë 22.01.2019 të {...}.

<sup>86</sup> Vendimi nr. {...}, datë 30.10.2019 i {...}.

<sup>87</sup> Vendimi nr. {...}, datë 18.07.2018, si dhe në të gjitha vendimet penale të themelit dhe ato të seancës paraprake;

<sup>88</sup> Vendimi nr. {...}, datë 22.12.2017 i {...}.

<sup>89</sup> Vendimet nr. {...}, datë 29.10.2018, nr. {...}, datë 30.10.2019, nr. {...}, datë 20.07.2018, nr. {...}, datë 03.10.2018, nr. {...}, datë 07.11.2017, nr. {...}, datë 21.09.2018, nr. {...}, datë 31.01.2018, nr. {...}, datë 06.05.2019 dhe nr. 746, datë 22.12.2017 të {...}.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

## **1.B ARSYETIMI LIGJOR**

### *1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.*

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjyqimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara, pas termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin. Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit,<sup>90</sup> apo si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik,<sup>91</sup> përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij, ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimin gjyqësor për çështjet familjare (*me objekt zgjidhje martese*), evidentohet kujdesi i gjyqtarës për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, me qëllim shmangien e fjalëve apo shprehjeve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke patur në vëmendje respektimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe respektimit të të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit.<sup>92</sup> I njëjti kujdes evidentohet edhe në çështjen penale që lidhet me veprën penale të “Kanosjes” apo “Vepra të turpshme”, ku, për shkak të natyrës së veprës, terminologjia e përdorur nga palët mbart ngarkesë emocionale që diktohet nga qëndrimi subjektiv dhe ngushtësisht personal i subjekteve në raport me perceptimin e faktit penal.<sup>93</sup>

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

<sup>90</sup> Vendimet nr. {...}, datë 13.05.2019, nr. {...}, datë 17.09.2018, nr. {...}, datë 16.04.2019, nr. {...}, datë 30.10.2019 dhe nr. {...}, datë 03.07.2019 të {...}.

<sup>91</sup> Vendimet nr. {...}, datë 07.11.2017 dhe nr. {...}, datë 03.10.2018 të {...}

<sup>92</sup> Vendimi nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>93</sup> Vendimi nr. {...}, datë 29.01.2019 dhe nr. {...}, datë 21.01.2019 i {...}.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar në shumicën e vendimeve me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë elementët proceduralë, si: kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet respektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këta elementë kanë qenë të diskutueshëm nga palët apo rrethanat e çështjes. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja. Po kështu, në disa nga vendimet e analizuara evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, gjithsesi i jep qartësi elementëve proceduralë të gjykimit ose vendimit, dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

## **KONKLuzioni**

*Në tërësi*, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjore, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristës/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda

duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë si pasojë e procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejmë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

*Pjesa përshkuese-arsyetuese* është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht me tituj, si: procedura, faktet e çështjes, pretendimet e palëve, legjislacioni i zbatueshëm, vlerësimi dhe analiza juridike e gjykatës, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) elementët proceduralë të vlerësuar nga gjykata (juridiksioni, kompetenca, formimi i trupit gjykues), vlerësimi për kërkesat procedurale të palëve, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) faktet thelbësore të çështjes (fakti penal apo faktet e çështjes civile objekt shqyrtimi), të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iii) ligjin e zbatueshëm, duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale penale dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm, ku të referon fakti juridik civil apo penal për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe (iv) vlerësimi i gjykatës, në të cilin merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen. Në disa prej vendimeve burim vlerësimi, diktuar nga kompleksiteti i tyre, pas arsyetimit dhe konkluzioneve të gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja paraqet në një pjesë të veçantë analizën dhe argumentimin lidhur me pretendimet e palëve.

*Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejmë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), apo në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor por edhe deklarimin e pafajshëm*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal*), por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 332/e dhe 329.b të K.Pr.Penale, në vendimet seancë paraprake, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale. Po kështu, vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë dhe nëndarje, çka lehtëson kuptueshmërinë e arsytimit të gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, përgjithësisht sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligji i zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata, të cilat në çështje komplekse janë shtruar në formën e pyetjeve të vlerësuara thelbësore për zgjidhjen e çështjes,<sup>94</sup> duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjyqtarja. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nëndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe brenda këtyre pjesëve mendimi është ndarë në paragrafë të cilat në pak raste paraqiten të gjatë por edhe këtu mendimi ka vijueshmëri. Kjo mënyrë strukturimi shërben për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

## KONKLuzioni

*Në tërësi*, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të mirë organizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij, duke mundësuar lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### ***1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsytimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballë gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur

<sup>94</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.



arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar<sup>95</sup>.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i detajuar, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale (*kryesisht çështje të kompetencës lëndore dhe tokësore, procedimit me gjykim të shkurtuar, shtimit të objektit të padisë etj.*).

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal, duke integruar qartë faktet me provat e administruara dhe aplikimin e ligjit mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Evidentohet kujdesi që tregon gjyqtarja në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes /çështjes dhe zgjidhjen e saj.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, gjyqtarja evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes, duke treguar kujdes të posaçëm për evidentimin dhe argumentimin e marrëdhënies shkak-pasojë, në përqasjen e ligjit me faktet konkrete. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

***Në çështjet civile*** gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh: (i) Të drejtës së pronës, duke u ndalur në konceptin, karakteristika e saj dhe tagrat që burojnë prej saj, si dhe padisë së rivendikimit si një ndër paditë për mbrojtjen e saj, referuar nenit 296 të K. Civil.<sup>96</sup>; (ii) Zgjidhjes së kontratës së punës, me fokus te zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e saj.<sup>97</sup>; (iii) Kompetencës lëndore në kuptimin e përgjithshëm, duke u ndalur në kuptimin dhe rëndësinë e saj, si dhe kriteret që shërbejnë për përcaktimin e saj, duke evidentuar jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me parimin “*gjykatë e caktuar me ligj*”, si dhe atë unifikuese të Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore<sup>98.99</sup>; (iv) Zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke u ndalur në këtë drejtim në pasojat në lidhje më mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, bazuar në

<sup>95</sup> Vendimi I GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

<sup>96</sup> Vendimi nr. {...}, datë 31.03.2017 i {...}.

<sup>97</sup> Vendimi nr. {...}, datë 13.03.2017 i {...}.

<sup>98</sup> Referohen vendimet nr. 19, datë 25.04.2013, nr. 16, datë 27.03.2012, nr. 23, datë 23.07.2009 dhe nr. 9, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me parimin “*gjykatë e caktuar me ligj*”, si dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 06.12.2013 në lidhje me kompetencën lëndore.

<sup>99</sup> Vendimi nr. {...}, datë 21.03.2017 i {...}.

parimin e interesit më të lartë të fëmijës.<sup>100</sup>; (v) Konceptin e titullit ekzekutiv, duke u ndalur në kuptimin dhe kategoritë e tij<sup>101</sup>.

Në vendimet penale burim vlerësimi, karakteristikë e gjyqtarës është veçimi dhe analiza e detajuar e fakteve esenciale të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe marrja në analizë e tyre në drejtim të ekzistencës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet, paraqitja e provave në lidhje me secilin fakt, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila provë në shërbim të provueshmërisë së tij, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurve, në raport me faktin penal të provuar.

Në çdo rast, interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimit logjik, për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë e elementëve të veprave penale për të cilat procedohet, ecurisë procedurale të gjykimit, kushteve dhe kritereve ligjore të individualizimit të dënimit, kushteve dhe kritereve ligjore të aplikimit të masave të sigurimit personal, aplikimit të alternativave të dënimit me burgim, apo edhe disponimit mbi kërkesat e fazës së seancës paraprake.

***Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve***, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi (*me aspektet procedurale të gjykimit, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj*). Pretendimet e palëve gjithnjë janë marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsyetimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsyetimit, por në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë me pretendimin konkret, duke u dhënë një përgjigje të argumentuar dhe duke u analizuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

## **KONKLUZIONI**

***Në tërësi***, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarës në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, përpara zbatimit të tij mbi faktet konkrete. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

---

<sup>100</sup> Vendimin nr. {...}, datë 16.01.2017 i {...}.

<sup>101</sup> Vendimi nr. {...}, datë 10.04.2017 i {...}.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës nw tregues “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, vlerwsohet “Shumë e lartë”, dhe pikwzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2.A AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË.

### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 539 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 539 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 150 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 389 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (150 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (539 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 27,8 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e vlerëson këtë tregues në shkallën “mbi mesataren”. Gjyqtarja parashton ndër të tjera “Në lidhje me këtë tregues, vlerësoj të theksoj se referuar statistikave në pamje të parë, rezulton se nga ana ime janë gjykuar rreth 27 % të çështjeve jashtë afatit ligjor. Megjithatë, në një analizë më të detajuar vlerësoj të evidentoj se jam përpjekur maksimalisht të respektoj afatet e parashikuara nga ligji, pavarësisht ngarkesës së lartë. Në këtë kuadër, vlerësoj të theksoj se caktimi për gjykim i çështjes është bërë në funksion të respektimit të afatit ligjor të gjykimit parashikuar nga ligji. Por, për shkaqe objektive, ka rezultuar e pamundur vendimmarja brenda këtij afati.” ..<sup>102</sup>.

Në përllogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarës), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përllogaritje do të zbriten:

<sup>102</sup>Gjyqtari ka referuar shpjegimet si më sipër, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në këtë projekt raport, por që parashtrihen në mënyrë të detajuar në raportin analitik, faqe 33-41 të tij, duke referuar të dhëna për disa çështje konkrete të cilat analizohen më sipër.

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët)
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve<sup>103</sup>

Duke vlerësuar me kujdes çdo çështje referuar tabelave me të dhëna statistikore (edhe ato për të cilat gjyqtarja nuk ka pasur pretendime) dhe shpjegimeve të gjyqtares në lidhje me kohëzgjatjen e disa prej tyre, rezulton si vijon:

(i) në çështjet me objekt “*Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit*”, tabela nr.2, viti 2017:

1. çështja me nr. rendor 10 (120) e shortuar më datë 24.01.2017 dhe e përfunduar me datë 31.01.2017 është gjykuar për 6 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 27.01.2017, por për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar nga ligji.***
2. çështja me nr. rendor 11 (127) e shortuar më datë 31.01.2017 dhe e përfunduar me datë 31.01.2017 është gjykuar brenda ditës pra ***brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar nga ligji.***
3. çështja me nr. rendor 18 (203) e shortuar më datë 14.02.2017 dhe e përfunduar me datë 20.02.2017 është gjykuar për 6 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë më datë 17.02.2017, por për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar nga ligji.***
4. çështja me nr. rendor 27 (133) e shortuar më datë 30.01.2017 dhe e përfunduar me datë 09.03.2017 është gjykuar për 1 muaj e 10 ditë ditë. Gjyqtarja pretendon se “*Nga verifikimi në sistem dhe në kompjuter me rezulton se objekt i kërkesës me nr.133 akti, është sqarim dhe interpretim vendimi bazuar në nenin 314 të K.Pr.Civile dhe nga ana e legjislatorit nuk është parashikuar detyrimi për ta gjykuar brenda 5 ditëve. Në këto kushte edhe kjo çështje është gjykuar brenda afatit ligjor*”, por nuk ka paraqitur vendimin apo ndonjë akt për të vërtetuar këtë pretendim. Në këto kushte, çështja do të konsiderohet e gjykuar jashtë afatit ligjor të parashikuar nga ligji.
5. çështja me nr. rendor 53 (462) e shortuar më datë 04.04.2017 dhe e përfunduar me datë 10.04.2017 është gjykuar për 6 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë më datë 07.04.2017, por për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar nga ligji.***
6. çështja me nr. rendor 80 (682) e shortuar më datë 25.04.2017 dhe e përfunduar me datë 02.05.2017 është gjykuar për 7 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë më datë 28.04.2017, por për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 2 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 5 ditor të parashikuar nga ligji.***

(ii) në çështjet me objekt « *Ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal* », tabela nr.10, viti 2017:

1. çështja me nr. rendor 45 (733) e shortuar më datë 29.09.2017 dhe e përfunduar me datë 31.10.2017 është gjykuar për 32 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë më datë 02.10.2017, por për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e

<sup>103</sup> Gjyqtarja, në pretendimet e saj për të mos konsideruar në përlllogaritje festat e fundvitit dhe kohën e mbartjes së dosjeve, nuk ka përcaktuar një afat konkret.

vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 2 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji.***

2. çështja me nr. rendor 56 (964) e shortuar më datë 14.11.2017 dhe e përfunduar me datë 12.12.2017 është gjykuar për 31 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë më datë 17.11.2017, por për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji.***
3. çështja me nr. rendor 59 (1010) e shortuar më datë 22.11.2017 dhe e përfunduar me datë 27.12.2017 është gjykuar për 35 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë më datë 27.11.2017, por për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji.***

(iii) në çështjet me objekt “*Ankim kundër vendimit të pushimit*”, tabela nr.11, viti 2017:

1. çështjet me nr. rendor 4 (616), 12 (455), 13 (545), 33 (602), 34 (605) dhe 52 (856) të pretenduara nga gjyqtarja si çështje që nuk duhen llogaritur në çështjet me afat ligjor, në të vërtetë nuk janë llogaritur si çështje me afat ligjor, por si çështje me standard minimal kohor, duke qenë se janë regjistruar para datës 1 gusht 2017, datë kur hyri në fuqi ligji 35/2017. Ky ligj parashikoi një afat prej 15 ditëve për shqyrtimin e çështjeve/ kërkesave, me objekt “*Ankimi kundër vendimit të pushimit*”<sup>104</sup>.
2. çështja me nr. rendor 19 (653) e shortuar më datë 05.09.2017 dhe e përfunduar me datë 07.11.2017 është gjykuar për 2 muaj e 2 ditë, jashtë afatit ligjor prej 15 ditë të parashikuar nga neni 329 i K.Pr.Penale.

(iv) në çështjet me objekt “*Dërgim çështje në gjyq*”, tabela nr.11, viti 2017:

1. çështja me nr. rendor 32 (888) e shortuar më datë 30.10.2017 dhe e përfunduar me datë 04.12.2017 është gjykuar për 34 ditë. Gjyqtarja pretendon që dosja është marrë më vonë se data e shortit, por për këtë pretendim nuk kemi të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji***<sup>105</sup>.

(v) në çështjet me objekt “*Miratim marrëveshje fajësie*”, tabela nr.8, viti 2018:

1. çështja me nr. rendor 3 (1904) e shortuar më datë 25.10.2018 dhe e përfunduar me datë 26.11.2018 është gjykuar për 31 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 26.11.2018 (ndërkohë në statistika rezulton data e shortit 25.10.2018), është marrë shorti më datë 30.11.2018 dhe është marrë vendim më datë 03.12.2018. Nga statistikat rezulton se data 03.12.2018 është data e dorëzimit të vendimit të arsyetuar, jo data e vendimit. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditor***<sup>106</sup> ***të parashikuar nga neni 406/dh.***
2. çështja me nr. rendor 17 (1559) e shortuar më datë 17.09.2018 dhe e përfunduar me datë 25.10.2018 është gjykuar për 38 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 17.09.2018, por është marrë shorti më datë

<sup>104</sup> Neni 329 pika 3 e K.Pr. Penale, parashikon se;”3.*Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.*”

<sup>105</sup> Neni 332 i K. Pr. Penale parashikon se;” 3. *Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj.*”

<sup>106</sup> Neni 406/dh, pika 2 i K. Pr. Penale, parashikon se;” 2. *Gjykata e shqyrton kërkesën në seancë gjyqësore Brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e saj. Seanca zhvillohet me praninë e detyrueshme të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Viktima njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë. Mosparaqitja e viktimës nuk pengon shqyrtimin e çështjes.*”

30.11.2018 dhe është marrë vendim më datë 03.12.2018. këto pretendime nuk vërtetohen nga statistika, për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar *jashtë afatit ligjor 30 ditor*<sup>107</sup> të parashikuar nga ligji.

(vi) në çështjet me objekt "*Miratim urdhëri penal*", tabela nr.9, viti 2018:

1. çështja me nr. rendor 10 (1046) e shortuar më datë 31.05.2018 dhe e përfunduar me datë 11.06.2018 është gjykuar për 11 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 31.05.2018, por është marrë më datë 04.06.2018. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 10<sup>108</sup> ditor të parashikuar nga ligji.***
2. çështja me nr. rendor 12 (2162) e shortuar më datë 11.12.2018 dhe e përfunduar me datë 24.12.2018 është gjykuar për 13 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 11.12.2018, por është marrë më datë 14.12.2018. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar *jashtë afatit ligjor 10 ditor të parashikuar nga ligji.*

(vii) në çështjet me objekt "*ankim ndaj vendimit të mosfillimit*" tabela nr.10, viti 2018:

1. çështja me nr. rendor 3 (1884), e shortuar më datë 23.10.2018 dhe e përfunduar me datë 26.12.2018, është gjykuar për 2 muaj e 6 ditë. Gjyqtarja pretendon se ankimi lidhet me pretendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe për rrjedhojë është gjykuar sipas ligjit. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar *jashtë afatit ligjor 30<sup>109</sup> ditor të parashikuar nga ligji.*
2. çështja me nr. rendor 8 (2026) e shortuar më datë 14.11.2018 dhe e përfunduar me datë 19.12.2018 është gjykuar për 1 muaj e 5 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 14.11.2018, por është marrë më datë 19.11.2018. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar *jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji.*
3. çështja me nr. rendor 36 (1037) e shortuar më datë 29.05.2018 dhe e përfunduar me datë 03.07.2018 është gjykuar për 1 muaj e 4 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 29.05.2018, por është marrë më datë 04.05.2018 (mendoj që është lapsus dhe gjyqtarja ka dashur të shkruajë 04.06.2018).. Gjithsesi, për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar *jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji.*
4. çështja me nr. rendor 44 (770) e shortuar më datë 06.04.2018 dhe e përfunduar me datë 07.05.2018 është gjykuar për 1 muaj e 1 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 06.04.2018, por është marrë më vonë. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji.***
5. çështja me nr. rendor 50 (527) e shortuar më datë 16.02.2018 dhe e përfunduar me datë 19.03.2018 është gjykuar për 31 ditë<sup>110</sup>. Gjyqtarja pretendon se

<sup>107</sup> Neni 406/dh I K. Pr. Penale

<sup>108</sup> Neni 406/b I K. Pr. Penale

<sup>109</sup> Neni 291 pika 3 e K. Pr. Penale, parashikon se:” 3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, i cili jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit. Ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore, por kur palët nuk paraqiten pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos mbi aktet e paraqitura.”

<sup>110</sup> Kujtojmë që shkurti 2018 ka pasur 28 ditë.

çështja është shortuar më datë 16.02.2018, por është marrë më vonë. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji.***

(viii) në çështjet me objekt "*dërgim çështje në gjyq*" tabela nr.11, viti 2018:

1. çështja me nr. rendor 13 (2107) është shortuar me datë 26.11.2018 dhe është përfunduar me datë 27.12.2018, është gjykuar për 31 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë me datë 30.11.2018. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga ligji<sup>111</sup>.***
2. çështja me nr. rendor 122 (1289) është shortuar me datë 16.07.2018 dhe është përfunduar me datë 20.09.2018, është gjykuar për 2 muaj e 4 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 35 ditë, pra ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
3. çështja me nr. rendor 123 (1315) është shortuar me datë 19.07.2018 dhe është përfunduar me datë 24.09.2018, është gjykuar për 2 muaj e 5 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 36 ditë, pra ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale***
4. çështja me nr. rendor 124 (1315) është shortuar me datë 12.07.2018 dhe është përfunduar me datë 17.09.2018, është gjykuar për 2 muaj e 5 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 36 ditë, pra ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
5. çështja me nr. rendor 126 (1253) është shortuar me datë 10.07.2018 dhe është përfunduar me datë 17.09.2018, është gjykuar për 2 muaj e 7 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 37 ditë, pra ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
6. çështja me nr. rendor 154 (1315) është shortuar me datë 15.05.2018 dhe është përfunduar me datë 12.06.2018, është gjykuar për 28 ditë, pra ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
7. çështja me nr. rendor 174 (787) e shortuar më datë 11.04.2018 dhe e përfunduar me datë 16.05.2018 është gjykuar për 1 muaj e 5 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 11.04.2018, por është marrë me vonesë..Gjithsesi, për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
8. çështja me nr. rendor 182 (764) e shortuar më datë 05.04.2018 dhe e përfunduar me datë 10.05.2018 është gjykuar për 1 muaj e 5 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 05.04.2018, por është marrë me vonesë. Gjithsesi, për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
9. çështja me nr. rendor 202 (676) është shortuar me datë 19.03.2018 dhe është përfunduar me datë 20.04.2018, është gjykuar për 31 ditë. Edhe për këtë çështje gjyqtarja pretendon se shorti është marrë me vonesë, por ne nuk kemi

---

<sup>111</sup> Neni 332 i K.Pr.Penale parashikon se;” 3. Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj.”

të dhëna që vërtetojnë këtë pretendim. Gjithsesi, tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditore të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

10. çështja me nr. rendor 182 (591) e shortuar më datë 28.02.2018 dhe e përfunduar me datë 03.04.2018 është gjykuar për 1 muaj e 4 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 28.02.2018, por është marrë me vonesë. Gjithsesi, për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditore të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

11. çështja me nr. rendor 262 (212) është shortuar me datë 05.01.2018 dhe është përfunduar me datë 07.02.2018, është gjykuar për 1 muaj e 2 ditë. Edhe për këtë çështje gjyqtarja pretendon se shorti është marrë me vonesë, por ne nuk kemi të dhëna që vërtetojnë këtë pretendim. Gjithsesi, tejkalimi me 2 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditore të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

12. çështja me nr. rendor 262 (212) është shortuar me datë 05.01.2018 dhe është përfunduar me datë 07.02.2018, është gjykuar për 1 muaj e 2 ditë. Edhe për këtë çështje gjyqtarja pretendon se shorti është marrë me vonesë, por ne nuk kemi të dhëna që vërtetojnë këtë pretendim. Gjithsesi, tejkalimi me 2 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditore të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

13. çështja me nr. rendor 269 (215) është shortuar me datë 05.01.2018 dhe është përfunduar me datë 06.02.2018, është gjykuar për 1 muaj e 1 ditë. Edhe për këtë çështje gjyqtarja pretendon se shorti është marrë me vonesë, por ne nuk kemi të dhëna që vërtetojnë këtë pretendim. Gjithsesi, tejkalimi me 1 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditore të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

14. çështja me nr. rendor 285 (1132) është shortuar me datë 20.12.2017 dhe është përfunduar me datë 22.01.2018, është gjykuar për 1 muaj e 2 ditë. Edhe për këtë çështje gjyqtarja pretendon se shorti është marrë me vonesë, por ne nuk kemi të dhëna që vërtetojnë këtë pretendim. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështja rezultoi e gjykuar brenda afatit 30 ditore, pra ***brenda afatit ligjor 30 ditore të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

(ix) në çështjet me objekt "*ankim ndaj vendimit të pushimit*" tabela nr.11, viti 2018:

1. çështja me nr. rendor 91 (1411) e shortuar më datë 30.07.2018 dhe e përfunduar me datë 11.10.2018 është gjykuar për 2 muaj e 11 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështja rezultoi e gjykuar për 1 muaj e 11 ditë; çështja me nr. rendor 149 (882) e shortuar më datë 30.04.2018 dhe e përfunduar me datë 20.06.2018, është gjykuar për 1 muaj e 20 ditë; çështja me nr. rendor 206 (623) e shortuar më datë 06.03.2018 dhe e përfunduar me datë 11.04.2018 është gjykuar për 1 muaj e 5 ditë; çështja me nr. rendor 250 (306) e shortuar më datë 30.01.2018 dhe e përfunduar me datë 22.02.2018 është gjykuar për 23 ditë; çështja me nr. rendor 292 (1708) e shortuar më datë 02.10.2018 dhe e përfunduar me datë 06.12.2018 është gjykuar për 2 muaj e 4 ditë; çështja me nr. rendor 293 (309) e shortuar më datë 17.01.2018 dhe e përfunduar me datë 16.02.2018 është



gjykuar për 30 ditë; çështja me nr. rendor 294 (1012) e shortuar më datë 20.12.2018 dhe e përfunduar me datë 22.01.2018 është gjykuar për 1 muaj e 2 ditë.

Gjyqtarja pretendon se për çështjet me objekt “Ankim ndaj vendimit të pushimit” nuk parashikohet afat ligjor. Ndërkohë, neni 329/3 i K.Pr. Penale, i ndryshuar me ligjin nr.35/2017, datë 30.03.2017, parashikon se; “*Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.*», dhe për pasojë të gjitha çështja do të konsiderohet e përfunduar *jashtë afatit ligjor 15 ditor të parashikuar nga ligji.*

(x) në çështjet me objekt “*Miratim urdhëri penal*”, tabela nr.9, viti 2019:

1. çështja me nr. rendor 20 (1501) e shortuar më datë 31.07.2019 dhe e përfunduar me datë 09.09.2019 është gjykuar për 40 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht (pretendim ky edhe i gjyqtarës), çështja rezulton e gjykuar për 9 ditë, pra ***brenda afatit ligjor 10 ditor<sup>112</sup> të parashikuar nga neni 406/b i K. Pr. Penale.***

(xi) në çështjet me objekt “*Miratim marrëveshje fajësie*”, tabela nr.9, viti 2019:

1. çështja me nr. rendor 24 (340) e shortuar më datë 10.11.2018 dhe e përfunduar me datë 29.01.2019 është gjykuar për 2 muaj e 19 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është shortuar më datë 10.01.2019 (pra, data në tabelen e statistikave është gabim). Për këtë pretendim nuk kemi të dhëna që ta vërtetojmë, për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 406/dh i K. Pr. Penale<sup>113</sup>.***

(xii) në çështjet me objekt “*dërgim çështje në gjyq*” tabela nr.11, viti 2019:

1. çështja me nr. rendor 54 (1500) është shortuar me datë 31.07.2019 dhe është përfunduar me datë 08.10.2019, është gjykuar për 2 muaj e 9 ditë. Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë pasi është kthyer nga pushimet vjetore të muajit gusht dhe ka disponuar brenda 30 ditëve. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi, edhe duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështja rezulton e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale<sup>114</sup>.***
2. çështja me nr. rendor 68 (1424) është shortuar me datë 26.07.2019 dhe është përfunduar me datë 26.09.2019, është gjykuar për 2 muaj. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështja rezulton e gjykuar për 25 ditë, pra ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
3. çështja me nr. rendor 108 (1162) është shortuar me datë 05.06.2019 dhe është përfunduar me datë 26.06.2019, është gjykuar për 21 ditë (sikurse është edhe pretendimi gjyqtarës, duke qenë se përlllogaritja në statistika është bërë gabim, 1 muaj e 21 ditë), pra ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
4. çështja me nr. rendor 120 (966) është shortuar me datë 09.05.2019 dhe është përfunduar me datë 11.06.2019, është gjykuar për 1 muaj e 2 ditë. Gjyqtarja

---

<sup>112</sup> Neni 406/b i K. Pr. Penale, parashikon se;” 1. *Gjykata e shqyrton kërkesën pa praninë e palëve dhe vendos brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i saj....”*

<sup>113</sup> Neni 406/dh, pika 2 e K.Pr.Penale, parashikon se; » 2. *Gjykata e shqyrton kërkesën në seancë gjyqësore brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e saj. Seanca zhvillohet me praninë e detyrueshme të prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Viktima njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë. Mosparaqitja e viktimës nuk pengon shqyrtimin e çështjes»*

<sup>114</sup> Neni 332 pika 3 i K.Pr.Penale parashikon se;” 3. *Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj » .*

pretendon se çështja është marrë më vonë, por këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë. Gjithsesi, tejkalimi me 2 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështja do të konsiderohet e përfunduar ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

5. çështja me nr. rendor 165 (650) është shortuar me datë 11.03.2019 dhe është përfunduar me datë 19.04.2019, është gjykuar për 1 muaj e 8 ditë, Gjyqtarja pretendon se çështja është marrë më vonë. Për këtë pretendim nuk ka të dhëna që e vërtetojnë dhe për pasojë, çështja rezulton e përfunduar ***jashtë afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***
6. çështja me nr. rendor 253 (2142) është shortuar me datë 06.12.2018 dhe është përfunduar me datë 14.01.2019, është gjykuar për 1 muaj e 9 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit, çështja rezulton e gjykuar për 31 ditë, pra duke e tejkaluar afatin 30 ditore me 1 ditë, afat që do të konsiderohet i pa përfillshëm, pra çështja do të konsiderohet e shqyrtuar ***brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 332 i K.Pr.Penale.***

(xiii) në çështjet me objekt "*ankim ndaj vendimit të pushimit*" tabela nr.11, viti 2019:

1. çështja me nr. rendor 247 (958) e shortuar më datë 01.11.2018 dhe e përfunduar me datë 21.01.2019 është gjykuar për 2 muaj e 20 ditë; çështja me nr. rendor 256 (2265) e shortuar më datë 26.12.2018 dhe e përfunduar me datë 06.05.2019, është gjykuar për 4 muaj e 10 ditë. Gjyqtarja pretendon se për çështjet me objekt "Ankim ndaj vendimit të pushimit" nuk parashikohet afat ligjor. Ndërkohë, neni 329/3 i K.Pr.Penale, i ndryshuar me ligjin nr.35/2017, datë 30.03.2017, parashikon se ; "*Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.*", pra përcakton një afat ligjor për shqyrtimin e tyre. Për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***jashtë afatit ligjor 15 ditor të parashikuar nga ligji.***

(xiv) në çështjet me objekt "*kërkesë për përjashtim gjyqtari*" tabela nr.12, viti 2019:

1. çështja me nr. rendor 43 (1156) e shortuar më datë 05.06.2019 dhe e përfunduar me datë 05.06.2019, është gjykuar brenda ditës. Sikurse pretendon edhe gjyqtarja përlllogaritja në tabelë është bërë gabim, duke e nxjerrë çështjen të përfunduar për 6 ditë. Pra, çështja rezulton e gjykuar ***brenda afatit ligjor 48 orë të parashikuar nga ligji.***

Për pasojë, duke konsideruar (i) shpjegimet e gjyqtarës lidhur me shortimin dhe planifikimin e çështjeve dhe (ii) tejkalimin e afatit me 1 ose 2 ditë, ***këto 24 çështje do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji.***

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuara më sipër, rezultoi se nga numri i çështjeve me afat ligjor (539 çështje) duhet të zbriten numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (150 çështje) dhe 24 çështje (pra nga numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit ligjor prej 150 duhet të zbriten 24 çështje të konsideruar të gjykuar brenda afatit ligjor), pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (126 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji

parashikon afat gjykimi (539 çështje), rezulton të jetë 23,3 %, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 9 pikë.

## KONKLUZIONI

*Në tërësi*, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*deri në 2 ditë*), raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (126 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (539 çështje), rezulton të jetë **23.3 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 9 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkallim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 23.3% (ii) ngarkesën e gjyqtares si relatore (*në total për tre vite ka gjykuar 1425 çështje, nga të cilat 37.8 % apo 539 çështje janë me afat ligjore*), duke gjykuar mesatarisht rreth 475 çështje në vit nga të cilat 149.6 janë me afat ligjore<sup>115</sup> dhe (iii) aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin si anëtare të trupa gjykues, kohën që gjyqtarja kalon në zhvillimin e seancave, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi, duke e pikëzuar me 12 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Respektimi i afateve ligjore” është e lartë, brenda marzhit “11-20 %”, dhe pikëzohet me 12 pikë.*

### 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 886 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (280 çështje në vitin 2017, 280 çështje në vitin 2018 dhe 326 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë”, “Tregtare me palë kundërshtarë”, “Familjare me palë kundërshtarë”, “Familjare pa palë kundërshtarë”, “Marrëdhënie pune”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje”, “Seanca paraprake” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;

<sup>115</sup> Nga dosja personale e gjyqtares rezulton se ajo fillimisht nga qenë në seksionin civil, dhe me urdhërin e Kryetarit të gjykatës nr.141, datë 02.05.2017 është caktuar për të gjykuar në seksionin penal (për të miturit). Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, t ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, parashikohet se; *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë ; a. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 çështje penale (krime dhe kundërvajtje)..e. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që i dhomës civile, si relator, jo më pak se 120 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtarë”.*

- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 886 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 140 prej tyre ose **15,8 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.**

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit, pretendon se ka kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme dhe ka caktuar seancat përgatitore/paraprake/gjyqësore në distanca të shkurtra kohore nga njëra-tjetra. Megjithatë, këto përpjekje jo në çdo rast i kanë shërbyer zgjidhjes së shpejtë të çështjes, për shkak të ndërhyrjes së rrethanave të tjera objektive si psh: pamundësisë së realizimit të komunikimeve për shkak të problemeve të adresave, kërkesave të bazuara të palëve për shtyrjen e seancave, caktimit për gjykim pas dorëheqjes së gjyqtarëve të tjerë, verifikimit të kushteve të pezullimit të gjyqimit etj.

Nuk rezulton që gjyqtarja të ketë referuar çështje apo të dhëna konkrete për çështje të caktuara, përveç shkaqeve të parashtruara në mënyrë të përmbledhur më sipër që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e tyre<sup>116</sup>.

Gjithsesi, lidhur me analizën logjike të të dhënave dhe përjashtimin e rrethanave që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, duhet të marrim në konsideratë disa fakte:

**Së pari**, standardet minimale kohore nuk janë afate të arsyeshme. Ato nxisin gjyqtarin të jetë sa më produktiv, pavarësisht ngarkesës në punë. Standardet orientuese janë indikator matës i performancës së gjyqtarit. Ndërsa qëllimi i afateve të arsyeshme nuk është përcaktimi në mënyrë taksative i afateve të arsyeshme të gjyqimit të çështjeve për gjyqtarin në vetvete, por si afate maksimale për përfundimin e tyre, shkelja e të cilave legjitimon kërkuesin palë në proces që të kërkojë dëmshpërblim.

**Së dyti**, afatet e përcaktuara me vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së për përfundimin e çështjeve (civile apo penale) kanë qenë dhe ende janë afate orientuese në funksion të menaxhimit dhe efikasitetit të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Këto afate orientuese shërbejnë si një standard matës për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, nëse ata në punën e tyre kanë ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore, e për rrjedhojë të përfundimit të çështjeve në një kohë sa më të shkurtër. Nga ana tjetër, tejkalimi i këtyre afateve orientuese, nuk nënkupton shkeljen e standardit të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së

**Së treti**, afatet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale të detyrueshme për tu zbatuar (*njoftimi i deklaratës së mbrojtjes, njoftimi me shpallje për palët...etj.*), apo edhe ato opsionale për tu zbatuar (*shpallja e arsyetuar e vendimit, etj.*) llogariten në afatin standard orientues të gjyqimit të çështjes. Standardet orientuese përfshijnë në vetvete edhe kohën që i duhet gjyqtarit për kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla si: shtyrjen deri në 20 ditë për

<sup>116</sup> Për më tepër shih formularin e vetëvlerësimit dhe raportin analitik, faqe 44.

shpallje të arsyetuar të vendimit ; shtyrjen deri në tre ditë për tu shprehur në lidhje me kërkesat e palëve ; respektimin e afatit 30/ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes ; afatit 20/ditor për njoftimin e palëve me shpallje, afati 5/ditor për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (neni 302/2 i K.Pr.Civile) etj.

**Së katërti**, afatet të cilat nuk janë në funksion të procesit (si p.sh. afati e kryerjes së lejes së zakonshme në muajin Gusht - leja vjetore) apo afatet të cilat ecin për shkak të disa veprimeve procedurale (si p.sh. koha e kaluar nga pezullimi i çështjes deri në rifillimin e saj, koha e kaluar nga data e ankimit të një vendimi të ndërmjetëm, faza e parë e pjesëtimit, ankim ndaj pezullimit të çështjes, parashtrimi i konfliktit të kompetencës Gjykatës së Lartë, etj.), janë afate, të cilat nuk duhet të llogariten në afatin orientues, pasi ato nuk ecin jo për shkak të menaxhimit jo të mire të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kontekst, këto afate nuk duhet të llogariten në kohëzgjatjen e gjykimit, për aq sa rezultojnë të referuara nga ana e gjyqtarit për çështje konkrete apo nga të dhënat e pasqyruara në tabelat statistikore. Po kështu duhet mbajtur në vëmendje edhe caktimi i gjyqtarës si relatores e çështjes, në ato raste kur çështja është shortuar pas dhënies së dorëheqjes apo përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë. Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtarja të ketë referuar të dhëna për kohën e pezullimit, kthimit të çështjes për vijimin e hetimeve, etj., për çështje konkrete, duke pamundësuar identifikimin dhe analizën e këtyre çështjeve. Për pasojë, në rastin konkret, duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, e vetmja e dhënë objektive që rezulton është kohëzgjatja e gjykimit dikuar nga leja vjetore në muajin gusht, e cila do të analizohet dhe zbritet në çështjet respektive.

Në përlllogaritjen e standardeve minimalë kohorë, për të gjitha dosjet, përlllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarës), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlllogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët)
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve.<sup>117</sup>

Duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar mbi pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtarës, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor çështjet si më poshtë:

- Çështjet civile në tabelën nr. 1, viti 2017 (civile të përgjithshme me palë kundërshtare), me nr. rendor 1 (2099), 51 (2642), 86 (1323) dhe 89 (1497) janë gjykuar për 6 muaj e 12 ditë, 6 muaj e 13 ditë, 6 muaj e 5 ditë dhe 6 muaj e pesë ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështjet rezultojnë të përfunduara për 4 muaj e 28 ditë, 6 muaj e 4 ditë, 5 muaj dhe 5 muaj. Tejkalmimi me 4 ditë në çështjen me nr. rendor 51 (2642) do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
- Çështjet civile në tabelën nr. 2, viti 2017 (civile të përgjithshme pa palë kundërshtare), me nr. rendor 2 (2879) dhe 72 (228) janë gjykuar për 2 muaj e 16 ditë dhe 2 muaj e 2 ditë, Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështjet rezultojnë të përfunduara për 2 muaj e 7 ditë dhe 2 muaj e 2 ditë. Tejkalmimi me 2 dhe 7 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduar **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

---

<sup>117</sup> Gjyqtarja, në pretendimet e saj për të mos konsideruar në përlllogaritje festat e fundvitit dhe kohën e mbartjes së dosjeve, nuk ka përcaktuar një afat konkret.

- (iii) Çështjet civile në tabelën nr. 3, viti 2017 (familjare me palë kundërshtare), me nr. rendor 13 (2630) dhe 47 (1426) janë gjykuar për 4 muaj e 17 ditë dhe 5 muaj e 4 ditë, Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit, mbartjes së dosjeve dhe pushimet e muajit gusht, çështjet rezultojnë të përfunduara për 4 muaj e 8 ditë dhe 4 muaj e 9 ditë. Tejkalimi me 8 dhe 9 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (iv) Çështja penale në tabelën nr. 9, viti 2017 (penale kundravajtje), me nr. rendor 5 (585) është gjykuar për 4 muaj e 4 ditë, Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështja rezulton e përfunduar për 2 muaj e 29 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (v) Çështjet penale në tabelën nr. 11, viti 2017 (seanca paraprake), me nr. rendor 4 (616) dhe 52 (856) janë gjykuar për 2 muaj e 4 ditë dhe 2 muaj e 4 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështja me nr. 4 (616) rezulton e përfunduar për 29 ditë. Tejkalimi me 4 ditë për çështjen tjetër me nr. 52 (856) do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (vi) Çështja penale në tabelën nr. 12, viti 2017 (kërkesa penale të fazës së ekzekutimit), me nr. rendor 7 (562), 8 (568), 9 (416) dhe 11(595) janë gjykuar për 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 3 muaj e 1 ditë dhe 3 muaj e 8 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështjet rezultojnë të përfunduara për 1 muaj e 3 ditë, 1 muaj e 1 ditë, 1 muaj e 26 ditë dhe 2 muaj e 3 ditë. Tejkalimi me 3 ditë për çështjen e fundit me nr. 11 (595) do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (vii) Çështja civile në tabelën nr. 1, viti 2018 (civile të përgjithshme me palë kundërshtare), me nr. rendor 3 (3199), është gjykuar për 6 muaj e 17 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, çështja rezulton e përfunduar për 6 muaj e 8 ditë. Tejkalimi me 8 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (viii) Çështjet penale në tabelën nr. 8, viti 2018 (penale krime), me nr. rendor 25 (854) është gjykuar për 10 muaj e 2 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit, mbartjes së dosjeve dhe pushimet e muajit gusht, çështja rezulton e përfunduar për 8 muaj e 20 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (ix) Çështja penale në tabelën nr. 9, viti 2018 (penale kundravajtje), me nr. rendor 1 (382) është gjykuar për 4 muaj e 13 ditë, Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështja rezulton e përfunduar për 3 muaj e 13 ditë, pra ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (x) Çështjet penale në tabelën nr. 11, viti 2018 (kërkesa penale për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi, kërkesë për pushim procedimi penal), me nr. rendor 28 (616), 105 (1204), 108 (1246), 109 (1173), 110 (1218), 114 (1341), 115 (1283), 119 (1330), 120 (1334), 125 (1203), 127 (1209) dhe 192 (562) janë gjykuar për 2 muaj e 4 ditë, 3 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 23 ditë, 3 muaj e 9 ditë, 2

muaj e 21 ditë, 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj e 10 ditë, 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj e 13 ditë, 2 muaj e 13 ditë dhe 2 muaj e 5 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit, mbartjes së dosjeve dhe pushimet e muajit gusht, çështjet rezultojnë të përfunduara për 2 muaj e 4 ditë, 2 muaj, 1 muaj e 18 ditë, 2 muaj e 4 ditë, 1 muaj e 16 ditë, 26 ditë, 1 muaj e 5 ditë, 26 ditë, 26 ditë, 1 muaj e 8 ditë, 1 muaj e 8 ditë dhe 2 muaj e 5 ditë. Tejkalimi me 4 dhe 5 ditë për çështjet me nr. 28 (616), 109 (1173) dhe 192 (562), do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

- (xi) Çështja penale në tabelën nr. 12, viti 2018 (kërkesa penale të fazës së ekzekutimit), me nr. rendor 11 (1298), 13 (1153), 14 (1322) dhe 16 (1155) janë gjykuar për 3 muaj e 6 ditë, 3 muaj e 12 ditë, 2 muaj e 16 ditë dhe 2 muaj e 25 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështjet rezultojnë të përfunduara për 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 1 muaj e 11 ditë dhe 1 muaj e 20 ditë. Tejkalimi me 1 dhe 7 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (xii) Çështjet penale në tabelën nr. 9, viti 2019 (penale kundravajtje), me nr. rendor 4 (329), 7 (854), 11 (2303), 12 (259) dhe 27 (448) janë gjykuar për 4 muaj e 23 ditë, 5 muaj e 3 ditë, 4 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 3 ditë dhe 4 muaj e 13 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve të muajit gusht, çështja rezulton e përfunduar për 3 muaj e 18 ditë, 3 muaj e 28 ditë dhe 3 muaj e 8 ditë. Për dy çështjet, 11 (2303), 12 (259), tejkalimi me 3 dhe 5 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (xiii) Çështjet penale në tabelën nr. 11, viti 2019 (kërkesa penale për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi, kërkesë për pushim procedimi penal) me nr. rendor 69 (1410), 78 (1254), 130 (733), 155 (622) dhe 205 (2239) janë gjykuar për 2 muaj e 10 ditë, 2 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 3 ditë dhe 2 muaj e 2 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e festave të fundvitit, mbartjes së dosjeve dhe pushimet e muajit gusht, çështjet rezultojnë të përfunduara për 1 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 3 ditë dhe 1 muaj e 23 ditë. Tejkalimi me 3, 4 dhe 5 ditë për çështjet me nr. 78 (1254), 130 (733), 155 (622) do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (xiv) Çështjet penale në tabelën nr. 11, viti 2019 (kërkesa penale për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat ligjor shqyrtimi, kërkesë për pushim procedimi penal), me nr. rendor 171 (674) dhe 172 (670) në tabelë thuhet se janë gjykuar për 2 muaj e 5 ditë, por nëse do të bëjmë llogaritjet ato janë shortuar më datë 12.03.2019 dhe kanë përfunduar më datë 17.04.2019, pra janë gjykuar për 1 muaj e 5 ditë, ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***
- (xv) Çështjet penale në tabelën nr. 12, viti 2019 (kërkesa penale të fazës së ekzekutimit), me nr. rendor 4 (1899), 28 (989) dhe 32 (996) janë gjykuar për 2 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 4 ditë dhe 2 muaj e 10 ditë. Tejkalimi me 2, 4 dhe 10 ditë do të vlerësohet i papërfillshëm dhe për pasojë çështjet do të konsiderohen të përfunduara ***brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.***

Për pasojë, duke konsideruar (i) shpjegimet e gjyqtarës lidhur me shortimin dhe planifikimin e çështjeve dhe (ii) tejkalimin e afatit orientues deri në 10 ditë, **këto 49 çështje do të konsiderohen si të përfunduara brenda standardit minimal kohor.**

Kështu, këto 49 çështje do t'i zbriten numrit të çështjeve të llogaritura në raportin analitik si të gjykuara jashtë standardit minimal kohor.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor rezulton të jetë jo më, 140 çështje, por 91 çështje, ose 10,2 % e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Kjo përqindje përkon me pikëzimin me 4 pikë.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë kriter maksimalisht duke i konsideruar të pakonsiderueshëm numrin e çështjeve të gjykuara tej afatit dhe se vonesat kanë ardhur për arsye objektive si psh: pamundësia e realizimit të komunikimeve për shkak të problemeve të adresave, kërkesave të bazuara të palëve për shtyrjen e seancave, caktimit për gjykim pas dorëheqjes së gjyqtarëve të tjerë, verifikimit të kushteve të pezullimit të gjykimit etj.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistike analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistike bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarës {...} të standardit sasior në fuqi, rezulton si më poshtë vijon :

Në lidhje me periudhën e vlerësimit 01.01.2017- 31.12.2019. që ajo ka punuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë rezultoi se znj. {...} ka punuar fillimisht në dhomën civile dhe nga muaji maj 2017 është caktuar për të punuar në dhomën penale, në seksionin për të mitur, duke punuar deri në përfundim të periudhës së vlerësimit.

Nga të dhënat statistike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjatë kësaj periudhe gjithsej 776 çështje me palë kundërshtare (civile të përgjithshme, familjare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvajtje dhe kërkesa për pushim procedimi). Referuar standardit sasior në fuqi<sup>118</sup>, gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare në vit si gjyqtare e dhomës civile dhe jo më pak se 100 çështje në vit si gjyqtare e dhomës penale. Në rastin konkret, rezultoi se gjyqtarja ka punuar në seksionin civile thujse vetëm gjysmën e vitit 2017 dhe për periudhën tjetër prej 2 vjet e gjysmë ka punuar në dhomën penale. Duke marrë për bazë këtë ndarje, gjyqtarja duhet të përfundojë gjatë një periudhë 6 mujore rreth 60 çështje me palë kundërshtare me natyrë civile dhe për periudhën 2 vjet e gjysmë në minimum rreth 250 çështje themeli, pra në total rreth

---

<sup>118</sup> Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, t ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, parashikohet se; *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë ; a. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 çështje penale (krime dhe kundërvajtje)..e. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që i dhomës civile, si relator, jo më pak se 120 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare”.*



310 çështje që të konsiderohet se ka plotësuar standardin minimal. Ndërkohë rezultoi se ajo ka përfunduar 776 çështje me palë kundërshtare apo penale themeli, duke tejkaluar këtë standard me rreth 466 çështje në periudhën tre vjeçare, ose në masën 150 %. Kështu, rezultoi se gjyqtarja ka përfunduar 258.6 çështje themeli (civile e penale), në një periudhë një vjeçare, duke e tejkaluar standardin minimal sasior sa i takon çështjeve penale të gjykuara, me rreth 150 %.

## KONKLuzioni

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezultojnë 10,2 % ; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit referuar shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 150 %, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 10,2 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (tejkallim i standardit sasior me 150 %).*

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- i. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 146 ditë (4 muaj e 26 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej gjashtë muaj;
- ii. Në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 58 ditë (1 muaj e 28 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “*Familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 107 ditë (3 muaj e 17 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “*Familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 35 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “*Tregtare me palë kundërshtare*”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 202 ditë (6 muaj e 28 ditë), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj;

- vi. Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 81 ditë (2 muaj e 21 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “Penale-krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 81 (2 muaj e 21 ditë) ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- viii. Në kategorinë e çështjeve “Penale-kundërvajtje”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 125 ditë (4 muaj e 5 ditë), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- ix. Në kategorinë e çështjeve “Seancë paraprake, kërkesa për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat ligjor gjykimi”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 35 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- x. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 55 ditë (1 muaj e 25 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja parashtron si shkaqe të kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të të vetmes çështje tregtare me palë kundërshtare fakti se e paditura është shtetase e huaj dhe ka qenë e pamundur njoftimi i saj në territorin e Republikës së Shqipërisë duke proceduar kështu me njoftimin me letër porosi. Sipas gjyqtares, kjo është edhe arsyeja e vonesës prej 20 ditësh.

Sa më sipër rezulton se në kategorinë “Tregtare me palë kundërshtare” është tejkualuar koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor. Bazuar në pretendimet e gjyqtares, në faktin që standarti, është tejkualuar vetëm për një çështje, së cilës, në përlllogaritje duhet t’i zbrisim 20 ditë të njoftimit me letër porosi, periudhën e festave të fundvitit dhe mbarjes së dosjeve (shortuar më datë 18.10.2016 dhe përfunduar më datë 12.05.2017) do të konsiderohet **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj.

Në lidhje me kategorinë e çështjeve “Penale-kundërvajtje”, ku rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 4 muaj e 5 ditë, duke e kaluar standardin minimal kohor të miratuar me vetem 5 ditë, tejkalimi i cili vlerësohet si i papërfillshëm, për pasojë koha mesatare që i dedikohet çdo çështje do të konsiderohet **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj.

## KONKLuzioni

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.<sup>119</sup> Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (10 nga 11 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “Penale-kundërvajtje”, ku standardi minimal kohor është tejkualuar me vetëm 5 ditë, çka vlerësohet tejkalim i papërfillshëm, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues.

<sup>119</sup> Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje duhet të konsiderohet më e shkurtër me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

#### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1419 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1406 çështje) brenda periudhës 3/vjeçare të vlerësimit, **është 100,9 %**, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 10 pikë.

Në vitin 2017 gjyqtarës i janë caktuar si relatore 412 çështje dhe ka përfunduar 460 çështje, me një rendiment prej 111,6 %.

Në vitin 2018 gjyqtarës i janë caktuar si relatore 524 çështje dhe ka përfunduar 461 çështje, me një rendiment prej 87,9 %.

Në vitin 2019 gjyqtarës i janë caktuar si relatore 470 çështje dhe ka përfunduar 498 çështje, me një rendiment prej 105,9 %.

Rendimenti i çdo viti tregon për një punë të qëndrueshme të gjyqtarës.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 100,9 %, e për këtë arsye gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, pasi rezulton me një rendiment + 99 %.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në tregues “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” pikëzohet 10 pikë, pasi rezulton me një rendiment +99 %.*

#### **2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- i. Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 4,5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.

Pr. Civile.

- ii. Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 2,6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- iii. Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 3,7 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- iv. Për çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- v. Për çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- vi. Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 6,3 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.
- vii. Për çështje të kategorisë “*krime*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 5,8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- viii. Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 4,2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- ix. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
  1. Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi, 2,6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale.
  2. Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 3,1 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar.
  3. Për kërkesa me objekt verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, 4,2 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K. Pr. Penale.
  4. Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, 3,1 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K. Pr. Penale.
  5. Për kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, 1,9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K. Penal.
  6. Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, 0 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K. Pr. Penale.
  7. Për kërkesa më objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, 5,5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural i

- përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- x. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
    - 1. Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 4,9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K. Pr. Penale.
    - 2. Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 4,4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
  - xi. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
    - 1. Për kërkesa me objekt shtyrje e ekzekutimit të vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 5,5 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 476 i K. Pr. Penale.
    - 2. Për kërkesa me objekt përjashtimin e gjyqtarit, koha mesatare e arsyetimit është 1,1 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 22 i K. Pr. Penale.
    - 3. Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 4,4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Nga 7 (shtatë) nën kategoritë e kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, vetëm në dy prej tyre, koha mesatare e arsyetimit e ka tejkaluar afatin procedural.

Për nënkategorinë “*kërkesa me objekt shtyrje e ekzekutimit të vendimit*”, koha mesatare e arsyetimit është vetëm 0,5 ditë (pra disa orë) më e gjatë se afati procedural prej 5 ditësh i parashikuar nga ligji, tejkallim që do të konsiderohet i papërfillshëm. Ndërkohë për dy nënkategoritë e tjera të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e shkurtër se afati që parashikon ligji. Kështu, për çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit do të vlerësohet është më e shkurtër se afati i parashikuar nga ligji.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja dhe kryetarja e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja ka parashtruar se “...Në lidhje me këtë tregues, vlerësoj të theksoj se të gjitha vendimet gjyqësore janë arsyetuar brenda afatit të parashikuar. Pavarësisht kësaj, referuar të dhënave statistikore rezulton se për çështjet me objekt “*Caktim mase sigurimi*” dhe “*Caktim mase sigurimi në mungesë*”, dorëzimi i vendimeve është bërë jashtë afatit ... Në lidhje me këto çështje, vlerësoj të sqaroj se për shkak të natyrës së tyre, vendimi gjyqësor i është dorëzuar i arsyetuar prokurorisë. Ndërkohë, në pritje të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, dosja gjyqësore ka vijuar të mbetet pranë meje. Vetëm pas ekzekutimit të vendimit, dosja gjyqësore është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore. Në të tilla rrethana, sekretaria gjyqësore nuk ka pasur se si të verifikojë momentin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar prej meje, por ka proceduar me shënimin si datë dorëzimi të vendimit të arsyetuar, datën e dorëzimit të dosjes pranë saj. Në këto kushte, vlerësoj se edhe për këtë tregues duhet të vlerësohem maksimalisht. Po kështu, po sqaroj se, që prej muajit Maj 2017 kam qenë pjesë e seksionit për të mitur dhe kërkesat e pasqyruara në tabelat përkatëse “*Caktim mase*” lidhen me deklarin e moskompetencës nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore dhe dërgimin për kompetencë lëndore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, seksioni i të miturve. Kështu, është

*proceduar me gjykimin e kërkesës brenda 10 ditëve nga marrja e akteve nga gjykata jo-kompetente dhe është disponuar me vendim për caktim mase (vleftësimi i ndalimit/arrestimit nuk ka qenë më objekt gjykimi për shkak të karakterit) dhe sipas ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin nr.35/2017, ndaj këtij vendimi ushtrohej ankim brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërme e shpalljes së vendimit. Kështu, gjykata ka pasur një afat 5 ditor për të arsyetuar dhe nga ana ime është respektuar maksimalisht ky afat. Konstatohet gjithashtu, se në dy raste është pasqyruar afati i arsyetimit 6 ditor, llogaritja është kryer duke ju referuar afatit të dorëzimit nga sekretarja. Konkretisht, e kam dorëzuar në ditën e pestë të afatit dhe nga ana e sekretares është dorëzuar dosja ditën e nesërme dhe për rrjedhojë afati i arsyetimit ka rezultuar 6 (gjashtë) ditë.”*

Ndërsa kryetari i gjykatës është shprehur si vijon: *“Të gjitha vendimet janë arsyetuar dhe dorëzuar brenda afateve ligjore. Për sa i përket çështjeve me objekt “Caktim mase sigurimi në mungesë” për shkak të sekretit hetimor ato janë mbajtur pranë gjyqtarës dhe në momentin e ekzekutimit ato janë dorëzuar në sekretari.”.*

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është tejkaluar vetëm në nënkategoritë e çështjeve me objekt “caktim mase sigurimi” dhe “verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit”, por kjo e dhënë, duke iu referuar (i) shpjegimeve të gjyqtarës dhe të kryetarit të gjykatës lidhur me mënyrën e administrimit dhe dorëzimit të dosjeve lidhur me kërkesat me karakter sekret dhe (ii) parashikimeve të ligjit procedural penal i cili në 244/1 dhe 248/2 të Kodit të Procedurës Penale parashikon disponimin e gjykatës më vendim të arsyetuar, nuk mund të vlerësohet si e saktë. Kjo pasi koha e dorëzimit të dosjes gjyqësore, pas kalimit të afatit për ruajtjen e sekretit hetimor, nuk përputhet me kohën e arsyetimit të vendimit, e cila në kuptim të dispozitave ligjore të mësipërme, vlerësuar së bashku me shpjegimet e gjyqtarës, vlerësohet se ka qenë e barabartë me afatin ligjor të arsyetimit.

***Sa më sipër***, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si *“Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”* dhe gjyqtarja duke të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.*

## **2.B AFTËSIA PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE.**

### ***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në tabelat me të dhëna statistikore nuk rezultojnë të dhëna për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet që gjyqtarja ka përfunduar në periudhën e vlerësimit 2017-2019. Për pasojë, të dhënat për vlerësimin e këtij treguesi i referohen numrit të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim. Referuar të dhënave të analizuar në Raportin analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) Për kategorinë “*Civile themeli me palë kundërshtare*” është 0 seanca (pasi gjyqtarja ka disponuar në veprime paraprake për shpalljen e moskompetencës lëndore për shqyrtimin e padisë).
- (ii) për kategorinë “*Familjare me palë kundërshtare*” është 4 seanca;
- (iii) për kategorinë “*Penale krime*” është 2.5 seanca;
- (iv) Për çështje të kategorisë “*penale kundravajtje*” është 1;
- (v) për kategorinë “*Penale seancë paraprake*” është 1.5 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, rezulton të jetë **2.25 seanca gjyqësore**.

Në më shumë se gjysma e çështjeve të shortuara, në 12 prej tyre, gjykimet janë mbyllur me një seancë.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile, si dhe duke përcaktuar provat që do të shqyrtohen në gjykim apo sipas K.Pr.P në çështjet penale, duke urdhëruar kryerjen e njoftimeve për palët dhe marrjen e masave për të siguruar prezencën apo shoqërimin e të pandehurve.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: për t'i dhënë kohë ekspertit për realizimin e aktit të ekspertimit, për t'i dhënë kohë palëve për të sjellë prova për të vërtetuar se nuk kanë mundësi për pagimin e aktit të ekspertimit; për t'i dhënë kohë palëve për të kryer pagesën e aktit të ekspertimit, me qëllim dhënien kohë mbrojtësit për të kontaktuar me të pandehurin, për përsëritjen e njoftimeve në rastet kur ato kanë rezultuar se nuk janë kthyer, për të mundësuar prezencën në seancë të prokurorit ose mbrojtësit, për shkaqe objektive që lidhen me arsye shëndetësore të gjyqtarës, për t'i dhënë kohë palëve për t'u njohur me aktet, përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim nga palët, shpalljen e vendimit etj.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

Vetëm në një rast evidentohet që seanca gjyqësore të mos jetë çelur për shkak të mos formimit të trupit gjykues por në këtë rast gjyqtarja referohet se ka munguar për arsye shëndetësore, duke marrë masa për caktimin e afërt të seancës së radhës dhe kryerjen e veprimeve për të siguruar pjesëmarrjen e palëve në seancën vijuese<sup>120</sup>.

Caktimi i seancës së parë gjyqësore në ato raste kur parashikohet një detyrim ligjor për t'u respektuar (si afat maksimal), rezulton që gjyqtarja e ka respektuar afatin në të gjitha rastet (në tre çështjet e kategorisë seancë paraprake, gjyqtarja për caktimin e seancës së parë gjyqësore ka respektuar afatin 5 ditë të parashikuar në nenin 329/b apo në nenin 332/1 të K.Pr.Penale, të ndryshuar). Përgjithësisht, rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 2 - 20 ditësh nga njëra – tjetra në çështjet civile/familjare dhe deri në 14 ditë, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale, në çështjet penale. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht, apo në fund të vitit, periudhë që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata.

## **KONKLUZIONI**

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtarë të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.25 seanca dhe në çdo rast gjyqtarja ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në nivel maksimal, duke e pikëzuar me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

<sup>120</sup> Shih çështjen që i përket vendimit nr. 114, datë 21.01.2019 të {...}.



## **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, në çështjet civile gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë pajtimi në çështjet familjare(*neni 158/ç i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes*) e në vijim, pas ezaurimit të seancave të pajtimit edhe për nxjerrjen e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda ditës në kërkesat penale ose brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenin 329/b për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën, por ka treguar edhe kujdes maksimal në marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), ose sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale*).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të të paditurve, shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, por ndeshen disa vonesa të cilat variojnë maksimalisht deri në 20 minuta (*vonesa të papërfillshme*) dhe vetëm 4 seanca janë zhvilluar me 27 minuta<sup>121</sup>, 23 dhe 36 minuta<sup>122</sup> si dhe 32 minuta vonesë<sup>123</sup>, vonesa të cilat lidhen me organizimin dhe përgatitjen e sallës për gjykim

<sup>121</sup> Vendim nr. 849, datë 07.11.2017

<sup>122</sup> Vendim nr. 39, datë 16.01.2017

<sup>123</sup> Vendim nr. 193, datë 13.05.2019

ose të diktuar nga kohëzgjatja e seancës pararendëse apo pjesëmarrja e gjyqtarës në gjykime të tjera në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio atëherë kur ka qenë e mundur, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 20 pikë.*

## **2.C AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE.**

### ***2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në secilën prej dosjeve të përzgjedhura me short është përfshirë gjithë dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtarja gjatë gjykimit konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të shfrytëzueshme dosjen. Dosjet kryesisht ndjekin renditjen logjike të aktet duke filluar me *aktet e shortit, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet dhe shkresat e hartuara nga gjykata në funksion të njoftimit të palëve apo komunikimit me të tretët, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimi gjyqësor përfundimtar, në çështjet penale*. Në çështjet civile aktet renditen duke ndjekur logjikën e grupimit të tyre sipas kategorisë duke filluar *aktet e shortit, kërkesë padinë, provat dhe aktet e përfaqësimit të palëve, aktet e ekspertimit të kryera gjatë gjykimit apo provat e marra nga të tretët, vendimet dhe aktet e komunikimit me palët gjatë veprimeve paraprake, përgatitore dhe urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore, së bashku me njoftimet, diskutimet përfundimtare me shkrim të palëve dhe vendimin gjyqësor përfundimtar*. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*veprimet paraprake, njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

Gjyqtarja e vlerëson maksimalisht këtë tregues duke u shprehur se "Në dosjet gjyqësore, përfshihen të gjitha aktet dhe provat e paraqitura nga palët të cilat janë administruar në seancë gjyqësore. Gjithashtu, dokumentacioni i administruar në dosje, është dokumentacioni që i përket çështjes gjyqësore konkrete."

## KONKLuzioni

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është "shumë e lartë" dhe pikëzohet me 5 pikë.*

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (kërkesëpadi, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (aktet e shortit, vendimet për vënien në lëvizje të çështjeve, kryerjen e veprimeve paraprake dhe përgatitore në gjykimet civile, komunikimet shkresore me të tretët dhe njoftimet për palët ndërgjyqëse, urdhri/vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, njoftimet drejtuar të pandehurit, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, bashkëlidhur "Letra e të drejtëve", procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet gjyqësore përfundimtare).

## KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është "Shumë e lartë" dhe pikëzohet me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A ETIKA NË PUNË

##### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se ndaj gjyqtares {...} në periudhën e vlerësimit 2017-2019 rezulton se janë paraqitur 3 ankesa. Konkretisht :

- (i) Ankesë e ankuesit {...}, ankesë e depozituar pranë KLGJ-së, regjistruar me nr. 1909 prot., datë 29.03.2019, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1091/4 prot., datë 14.07.2020.
- (ii) Ankesë e ankuesit, e depozituar pranë KLGJ-së, regjistruar me nr. 5090 prot., datë 02.12.2019, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1091/2 prot., datë 14.07.2020.
- (iii) Ankesë e ankuesit, e depozituar pranë KLGJ-së, regjistruar me nr. 6394 prot., datë 24.12.2019, e cila më pas është regjistruar pranë ILD-së me nr. 1091/3 prot., datë 14.07.2020.

Gjatë shqyrtimit fillestar të ankesave, për shkak se rezultoi t'i përkasin të njëjtit ankues, drejtohen ndaj të njëjtëve magistratë dhe pretendohen të njëjtat shkelje, me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur bashkimi i tyre dhe trajtimi i përbashkët në të njëjtin akt. Në përfundim të shqyrtimit fillestar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1091/7 prot. datë 22.12.2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi {...}.”.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2017-31.12.2019 për gjyqtaren {...}, nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtares në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të çenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtares në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.*

### **3.B INTEGRITETI I GJYQTARIT**

#### ***3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD-së 3 ankesa, për të cilat është vendosur arkivimi pas shqyrtimit fillestar.

Nga tërësia e fakteve të parashtruar dhe të analizuar në vendimin e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që çenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 2807/1 prot., datë 09.07.2021, rezulton se: Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konstatohet se për gjyqtaren....: {...} “a) Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar është konstatuar konflikti i interesave, për çështje të veçanta, neni 21, pika 1, i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, për aq sa babai i subjektit, shtetasi {...}, administrator dhe ortak me 100% të aksioneve të shoqërisë {...}i identifikuar me NUIS (NIPT) {...}, është shpallur fitues në

procedurat e prokurimit elektronik dhe ka lidhur kontrata me institucionet publike, gjatë periudhës 1.1.2017-31.12.2020. Në vijim të shkëljes së konstatuar në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, **është marrë masa administrative**, si dhe është zgjidhur konflikti i interesave për të ardhmen, ku shtetasi {...} (babai i subjektit) ka dhuruar aksionet e shoqërisë {...} në masën 100% të kuotave.”

Situata e konfliktit të interesit për të cilën ILDKPI ka vendosur masë administrative të sipërpërmendur, është trajtuar në vendimin nr. {...}, datë {...} të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>124</sup>. Në këtë vendim, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka arsyetuar se: “...19.4. Pasi analizoi kërkimet e Komisionerit Publik në ankim dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në periudhën kohore nga viti 2014 deri në vitin 2021, për shkak të kontratave të lidhura nga shoqëria tregtare, pronar i vetëm dhe administrator i së cilës është babai i subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht nga ky konstatim, në rrethanat konkrete, faktet që rezultuan nga analiza e kryer në Kolegj, nuk mund të passjellin zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e Komisioneres Publike në vlerësimin e parashtruar në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, janë të bazuara. 19.5. Konkluzioni i mësipërm merr në konsideratë sa konfirmuan aktet e administruara në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka deklaruar se ka marrë njoftim për herë të parë për konfliktin e interesit në datën 20.5.2021, nga ILDKPKI-ja. Në analizë të akteve dhe veprimeve të ndërmarra prej saj, dokumentuar edhe në vijim, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh për të verifikuar dhe shëruar gjendjen e konfliktit të interesit, si në lidhje me pasuritë që ka pasur në përdorim dhe në pronësi (automjeti), ashtu dhe për shkak të aktivitetit që ushtronte i ati. 19.7. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur në Komision, subjekti ka provuar nëpërmjet akteve se nuk ka dhënë vendime në kushtet e konfliktit të interesit. .... 19.9 Së fundmi, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjykatës dhe ka fituar padinë për të rrëzuar vendimin e Inspektoratit të Lartë të ILDKPKI-së që ka disponuar me gjobë për të dhe ka konstatuar se ajo gjendet në kushtet e konfliktit të interesit [cituat më sipër në paragrafin 10.4/d]. Sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 02.07.2021, detyrimin për të shmangur konfliktin e interesit, e ka personi i lidhur me zyrtarin dhe, për pasojë, gjoba e vendosur duhet t’i ngarkohet babait të subjektit të rivlerësimit.

19.10 Duke abstraguar nga vendimi gjyqësor i sipërcituar dhe fakti që ligji nr. 9367 ka fushë veprimi vetëm funksionarët publikë dhe nëpërmjet tyre, personat e njësuar me ta, dhe ndalon shprehimisht kontratat publike, **trupi gjykues i Kolegjit çmon se veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, pasi mori njoftim për gjendjen e konfliktit të interesit, kanë qenë gjithëpërfshirëse dhe krijojnë bindjen se kanë plotësuar gjithë nevojat për shmangien e këtij konflikti në të ardhmen.**

19.11 Ndonëse qëndron përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që të identifikonte këto aspekte, trupi gjykues vëren dhe njëherazi vlerëson se ka disa aspekte faktike, të cilat çojnë në konkluzionin se konflikti i interesit i konstatuar nuk mund të përbëjë shkëlje nën dritën e ligjit nr. 84/2016 dhe as të sjellë pasojën e shkarkimit në procesin e rivlerësimit, si në drejtim

---

<sup>124</sup> Me vendimin nr. {...}, datë {...}, Kolegji i Posaçëm i Apelit, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. {...}, datë {...} të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Ndërkohë, me vendimin nr. {...}, datë {...}, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.”

*të kriterit të vlerësimit të pasurisë, për sa kohë nuk rezulton se subjekti ka krijuar ndonjë pasuri për shkak të kësaj gjendjeje, ashtu edhe në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për sa kohë që subjekti nuk rezulton të ketë gjykuar ndonjë çështje në kushtet e konfliktit të interesit. Në këtë konsideratë, trupi gjykues pati parasysh ndër të tjera: shkëputjen gjeografike të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, nga prindërit për shkak të shkollës, veprimet e menjëhershme të kryera që tregojnë gatishmërinë e saj dhe të personave të lidhur në kuptim të ligjit nr. 9367/2005 për të përmbushur ligjin dhe mbështetur subjektin me përgjegjësi dhe përkushtim në kryerjen e detyrës prej saj, faktin që nuk rezulton që babai të ketë pasur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku subjekti ushtronte detyrën, faktin që subjekti i rivlerësimit duket se ka ndërmarrë hapa që të shkëpusë edhe interesat e saj financiarë nga prindërit dhe që subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë krijuar të ardhura, pasuri apo përfitime si pasojë e situatës së konfliktit të interesit.”*

Referuar sa më sipër, rezulton se Kolegji i Posaçëm e Apelimit si organ kushtetues që ka shqyrtuar ankimin ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit {...} ka konkluduar se ajo ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në periudhën kohore nga viti 2014 deri në vitin 2021, për shkak të kontratave të lidhura nga shoqëria tregtar, pronar i vetëm dhe administrator i së cilës është babai i subjektit të rivlerësimit, porse referuar disa aspekteve faktike ka vlerësuar se konflikti i interesit i konstatuar nuk mund të përbëjë shkelje nën dritën e ligjit nr. 84/2016 dhe as të sjellë pasojën e shkarkimit në procesin e rivlerësimit, si në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, për sa kohë nuk rezulton se subjekti ka krijuar ndonjë pasuri për shkak të kësaj gjendjeje, ashtu edhe në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për sa kohë që subjekti nuk rezulton të ketë gjykuar ndonjë çështje në kushtet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rezultoi se më parë, nga ILDKPI është marrë masa administrative e vendosjes së gjobës ndaj gjyqtarës {...}, për shkak se është konstatuar konflikti i interesave, për çështje të veçanta, neni 21, pika 1, i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, “Ndalimi i lidhjes së kontratave”, dhe se ndaj këtij vendimi gjyqtarja ka paraqitur ankim në gjykatë, e cila është pranuar atë, duke vendosur heqjen e kësaj gjobe ndaj subjektit, vendime këto që janë shqyrtuar më pas nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimin e sipërcituar.

Duke marrë në konsideratë se; vendimi i ILDKPI që ka disponuar me gjobë për gjyqtaren dhe ka konstatuar se ajo gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shallës së Parë dhe është fituar nga gjyqtarja duke u vendosur rrezimi i vendimit të ILDKPI-së; nuk rezulton se gjyqtarja ka krijuar ndonjë pasuri për shkak të kësaj gjendjeje, pra konfliktit të interesit, por ka ndërmarrë hapa që të shkëpusë edhe interesat e saj financiarë nga prindërit; Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vërejtur dhe vlerësuar se ka disa aspekte faktike, të cilat çojnë në konkluzionin se konflikti i interesit i konstatuar nuk mund të përbëjë shkelje nën dritën e ligjit nr. 84/2016 edhe në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale; gjyqtarja nuk rezulton të ketë gjykuar ndonjë çështje në kushtet e konfliktit të interesit; faktin se nuk rezultoi se babai i saj të ketë pasur kontrata publike në zonën e kompetencës territoriale të gjykatës ku ajo ushtronte detyrën, veprimet e ndërmarra nga gjyqtarja për shmangien e konfliktit të interesit, të cilat kanë qenë gjithëpërfshirëse, të cilat krijojnë bindjen se kanë plotësuar gjithë nevojat për shmangien e këtij konflikti në të ardhmen, vlerësoj se gjyqtarja ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesin në dukje, përse kohë që gjatë punës së saj ajo nuk ka gjykuar edhe as ka marrë ndonjë vendim në kushtet e konfliktit të interesit, duke shmangur kështu të gjitha paragjykimet lidhur me vendimarrjet e saj.

Kështu referuar burimeve të vlerësimit, vlerësoj se gjyqtarja me sjelljen dhe veprimet e saj ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, duke u kujdesur që të ruaj integritetin e saj gjatë ushtrimit të detyrës por edhe jashtë saj, duke shmangur menjëherë sapo është vënë në dijeni të situatave të cilat mund të krijojnë përcëptime për favorizime apo disfavorizime në çështje të caktuara, si dhe duke shmangur sjelle që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe normat etike e morale. Gjithashtu, vlerësoj se nuk rezultoi asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtares në nivel shumë të lartë.

## **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit në tërësi, masave të menjëhershme dhe gjithpërfshirëse të ndërmarra nga gjyqtarja për shmangien e konfliktit të interesit, sapo ajo është vënë në dijeni të ekzistencës së konfliktit të interesit, faktin se nuk konstatohet se gjyqtarja të ketë gjykuar çështje në konflikt të interesit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e integritetit të gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

## **3.C PAANËSIA E GJYQTARIT**

### ***3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjuha e përdorur është korrekte dhe teknike.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivelin shumë të lartë.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.



*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se:

Për vitin 2017, janë paraqitur 4 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, të cilat janë rrëzuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 2 kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

Për vitin 2018, është paraqitur 1 kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, e cila është rrëzuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 7 kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

Për vitin 2019, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 2 kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

Kështu, për të gjithë periudhën e vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, janë paraqitur 5 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, të cilat janë rrëzuar. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 11 kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim si të pa konsiderueshëm.

### **KONKLuzioni**

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, janë paraqitur 5 kërkesa për përjashtimin e saj, të cilat janë rrëzuar të gjitha, pra kërkesat e pranuar janë 0.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit

KRITERI

ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE

Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT.

###### 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë dhe transparente. Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë dhe drejtpërdrejtë. Në raportin analitik, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përdor fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta. Ndërkohë, ajo ndërton shpesh edhe fjali të gjata, por kjo me qëllim që të mos ndërpresë mendimin.

Gjyqtarja nuk është shprehur në lidhje me këtë tregues ndërsa kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarës në nivel shumë të lartë: *“Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira komunikimi. Gjuha e përdorur nga gjyqtarja në proces është e qartë dhe e kuptueshme për palët.”*

##### KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

###### 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai është në detyrë të dijë për shkak të funksionit.

Gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në shkallë të lartë. Gjyqtarja shprehet se “Çështjet sensitive për shkak të natyrës së tyre dhe informacioneve që përmbajnë janë zhvilluar me dyer të mbyllura.”.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

### **4.B AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR.**

***4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Nga rezultatet e verifikimit të ankesave nga ana e ILD nuk ka asnjë të dhënë burimore që mund të vlerësohet në drejtim të këtij treguesi.

Gjyqtarja dhe kryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel të lartë.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

***4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të

lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore, në funksion të krijimit të një ambienti pune harmonik dhe produktiv.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

## **4.C GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

### ***4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 14 (katwrbwdhjetw) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 03.04.2017 deri në datë 8-11.2019), gjithsej 24 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, por nuk mungojnë as aktivitetet në të drejtë civile gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 24 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi nuk ka marrë pjesë si ekspert/lehtësues në programe të trajnimit fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e ekspertes/lehtësueses, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

## **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

*Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në lidhje me treguesin "Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve", gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.*

### **4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, ka rezultuar se referuar dosjes personale të gjyqtarët nuk evidentohet të dhëna lidhur me këtë tregues.

Nga ana e saj, në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja është shprehur se: "...për vitin akademik 2019-2020 kam marrë pjesë si pedagoge e jashtme në fushën e së drejtës penale, niveli "Master", pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë."<sup>125</sup>.

Sipas vërtetimit nr. 1689/5 prot. Datë 11.12.2019 i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i ndodhur në dosjen e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} ka qenë personel akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2018-2019, pranë Departamentit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Humane.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

<sup>125</sup> Vërtetim nr. 1689/5 prot. Datë 11.12.2019 i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja {...} të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera dhe konkretisht në fushën e mësimdhënies.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.*

### 4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, duke e pikëzuar me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

## F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	390	Shkëlqyeshëm

### **PROPOZIME DHE REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES</b>			<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
			<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Treguesit</b>	<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>	<b>Pikët</b>	<b>Të dhëna për metodologjinë</b>
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë



		vlerësim			Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësim</b>
				<b>97</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>	<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>	

		treguesit			
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	11-20 %	12	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për

					të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	<b>Tej standardit :</b> Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha

					kategori të e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtares:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtares:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtares</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtares :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

		të ILDKPKI			
<b>C. Paanësia e gjyqtares</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranura të palëve për përjashtimin e gjyqtares:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>93</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

		<p>4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</p>			
	<p>b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale</p>	<p>1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</p>	<p>I lartë</p>	<p>15</p>	<p><b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë</p>
<p><b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b></p>	<p>a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta</p>	<p>1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave</p>	<p>Shumë e lartë</p>	<p>15</p>	<p><b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë</p>

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtares:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë



		profesionale të gjyqtares			
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>			<b>390</b>		
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES</b>			<b>Shkëlqyeshëm</b>		

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**